

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6152
E premte, 30 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Kosova dhe Maqedonia e Veriut së shpejti me pikë të përbashkët kufitare

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI | FAQE 4-5

QEVERIA QË KA MINISTËR VULININ, S'MUND TË SJELLË ASGJË TË RE



Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka bërë me dije se gjendja e shqiptarëve në Luginë të Preshevës është përkeqësuar. Ai ka kritikuar qeverinë

e re të Serbisë, duke thënë se shqiptarët nuk kanë ndonjë prirje nga ajo. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se një qeveri që ka njerëz si Aleksandër Vulini nuk

mund të sjellë asgjë të re. Sipas tij, as opozita e cila i ka bojkotuar zgjedhjet nuk paraqet ndonjë opsion të qartë të shkëputjes reale nga politikat e kaluara

2 869 RASTE AKTIVE ME COVID NË KOSOVË

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka raportuar të enjten për 284 persona të infektuar me Covid-19, ndërkaq gjatë 24 orëve të fundit është shënuar edhe një vdekje. Rezultatet e të infektuarve janë në bazë të 1 058 mostrave të testuara. Sipas njoftimit të IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar edhe 72 pacientë, kurse raste aktive janë 2 869. Ndërkaq komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë ka miratuar të enjten planin për parandalim dhe kontroll të Covid-19 (nëntor-prill 2021), versionin 2.0 | FAQE 3



Serbia sërish në Bruksel kërkon asociacion me kompetenca ekzekutive

FAQE 3

OPINION

AJO KOHË DHE KJO KOHË F. 11

Nga Xhavit ALIU



AKTUALE

KODI ZGJEDHOR, KUVENDI I SHOIPËRISË RRËZON DEKRETIN E METËS F. 2

KUVENDI DËSHTON SËRISH QË TË VOTOJË PROJEKTLIGJE DHE REZOLUTA F. 3

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE, NË LINJË ME RAPORTIN E KE-së F. 7



EKONOMI

HOTI FLET PARA KOMPANIVE AMERIKANE PËR PLANET E ZHVILLIMIT EKONOMIK F. 8

SHEFI I BE-së NË KOSOVË NGRIT SHOQËTËSIMIN PËR VJEDHJEN E MBI 2 MILIONË EUROVE F. 8

SPORT

PËRURORHET FUSHA E TENISIT NË FERIZAJ F. 14



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Covid-19 do t'i kushtojë Austrisë 54 miliardë euro

VJENË, 29 TETOR - Këshilli Fiskal i Austrisë ka llogaritur se si pasojat e krizës së Covid-19 do të ndikojnë në buxhetin e këtij viti dhe në vitin e ardhshëm. Sipas vlerësimeve, vetëm këtë vit pandemia do

të kushtojë 34.6 miliardë euro, ndërsa vitin e ardhshëm 19.2 miliardë euro. Vlerësimi i Këshillit Fiskal bazohet në supozimin se do të ketë një zhvillim pozitiv vitin e ardhshëm. Barra prej 53.8

miliardë eurosh për buxhet për këto dy vjet përfshin kostot e masave stimuluese, si dhe pasojat e rënies ekonomike. Presidenti i Unionit Fiskal, Martin Kocher, ka thënë se ai ishte i

mendimit që "bllokimi", siç ishte në pranverë, duhet të shmanget. Në të njëjtën kohë, ai paralajmëroi se numri në rritje i të infektuarve rrishtas ka një ndikim negativ në aktivitetet ekonomike. Sipas



Këshilli Fiskal, pasojat e pandemisë do të ndihen deri në vitin 2024.

Mali i Zi kërkon ndihmën e Interpolit për kërcënimet ndaj Dritan Abazoviqit

PODGORICË, 29 TETOR - Mali i Zi ka kërkuar ndihmën e Interpolit për shkak të kërcënimeve përmes mediave sociale ndaj Dritan Abazoviqit, udhëheqës i Aksionit të Reformës së Bashkuar (URA).

Policia malazeze identifikoi R. Sh nga Rozhaja, i cili kërcënoi Dritan Abazoviqin, përmes rrjetit social "Facebook". Por, meqenëse R. Sh nuk jeton në Mal të Zi, u kërkua ndihma e Interpolit. Kjo u konfirmua për "Radion Evropa e Lirë" nga policia malazeze. "Sipas deklaratës së një të afërmi të ngushtë, R. Sh nuk jeton në Mal të Zi, por në Suedi dhe

kemi përcjellë një kërkesë për Interpol-in në Suedi përmes Departamentit për Bashkëpunim Operacional, duke kërkuar kontrolle të caktuara për këtë person", thuhet në përgjigjen e policisë. Përmes komenteve në "Facebook" dyshohet se R. Sh më 10 shtator i tha Abazoviqit se do të masakrohej nëse vazhdonte "miqësinë" e tij, domethënë negociatat dhe bashkëpunimin me "çetnikët". Kjo çështje, sipas policisë, po trajtohet nga Prokuroria e Ulqinit. "Abazoviqi u informua për aktivitetet e ndërmarra dhe deklaroi se ai nuk ndihej i kërcënuar në lidhje me këto

kërcënime", ka njoftuar policia.

Për shkak të një sërë kërcënimesh, më 3 shtator, URA kërkoj një vlerësim urgjent të sigurisë së udhëheqësit, Dritan Abazoviq dhe pronës së tij nga Agjencia e Sigurisë Kombëtare e Malit të Zi (ANB) dhe Drejtoria e Policisë.

Koalicioni "E zeza mbi të bardhë" i udhëhequr nga Dritan Abazoviq, ai "Për të ardhmen e Malit të Zi" në krye me Frontin Demokratik dhe koalicioni "Paqja është kombi ynë" dolën fitues të zgjedhjeve parlamentare që u mbajtën më 30 gusht në Mal të Zi.



Jozefina Topalli paraqet nismën e re politike



TIRANË, 29 TETOR - Ish-kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, ka prezantuar nismën e re politike "Lëvizja për ndryshim". Në një podium ku shfaqej slogani "Bashkë për ndryshim", Topalli është shprehur se Shqipëria po rrëshqet në mënyrë të vazhdueshme prej pushtetit të gabuar. Ajo theksoi se qytetarët duhet t'i bashkohen nismës që në pushtet të mos jenë më Meta, Rama apo Basha, por vetë shqiptarët. "Ku ka më mirë e më shpresëdhënëse që këtë lëvizje

ta nisë brezi i ri. Dua t'i falënderoj edhe miqtë amerikanë që janë të pranishëm. Jam sot bashkë me këta të rinj duke i mbështetur në projektin e ri. Vendi ynë është në zgrip. Prej vitesh nuk rriten rrogat, por çmimet. Pasiguria është bërë dëshpëruese në një vend që zbrazet e plakët. Është një frikë mbytëse se vendi ynë po rrëshqet në mënyrë të vazhdueshme. Sfidat me të cilat po përballemi janë reale e të shumta, janë të vështira e nuk zgjidhen duke u shprehur.

Nuk zgjidhen në një pushtet të rremë. Nuk ka ku të jepet drejtësi, se nuk ka as Gjykatë Kushtetuese e as të Lartë. Duke ditur këtë, asnjëri nuk është i sigurt. Të gjithë po përballemi me këto sfida. Ata të tre bashkohen bukur fort për t'i ruajtur karriget e veta. Ata veprojnë sikur Shqipëria është pronë e tyre dhe se shqiptarët janë rrogëtarët e tyre. Ata vendosin se kush duhet të bëjë biznes me ata", ka thënë Topalli. Ajo u bëri të gjithëve thirrje që t'i bashkohen kësaj nisme për të sjellë ndryshim.

Kodi zgjedhor, Kuvendi i Shqipërisë rrëzon dekretin e Metës

TIRANË, 29 TETOR - Mazhoranca në Shqipëri ka rrëzuar dekretin e presidentit Ilir Meta, i cili ktheu për rishqyrtim ndryshimet në kodin zgjedhor. Ishin 96 deputetë të Kuvendit që kanë votuar për rrëzimin e dekretit të Metës. Pas kësaj, kodi i ri zgjedhor do të hyjë automatikisht në fuqi pa ndryshimet që kërkonte presidenti Ilir Meta dhe opozita jashtëparlamentare. Me rrëzimin e dekretit tashmë mbetet në fuqi formula e koalicionëve, ku

partitë duhet t'i grupojnë kandidatët në një listë të vetme.

Presidenti Ilir Meta ka reaguar pas rrëzimit të dekretit të tij, ku kthente për rishqyrtim kodin e ri zgjedhor. "Asnjë surprizë nga Kuvendi i inceneratorëve dhe mbetjeve. Me qetësi dhe dashuri!", ka shkruar shkurt presidenti Meta në një postim në llogarinë e vet në "Facebook".

Kryeministri Edi Rama kishte bërë të qartë rrëzimin e dekretit të



presidentit, pavarësisht se ai e dërgoi kodin e ri zgjedhor në Komisionin e

Venecias dhe pavarësisht prej deklaratave të komisionarit për zgjerim,

Oliver Varhelyi, se do të ishte më mirë të pritej opinioni i komisionit.

Serbia sërish në Bruksel kërkon asociacion me kompetenca ekzekutive

Në Bruksel është zhvilluar të enjten një raund i ri i takimeve në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë me pjesëmarrjen e shefave të delegacioneve. Qeveria e Kosovës ka lëshuar një komunikatë pas këtij takimi në të cilën thuhet se temë e diskutimit ishte zgjidhja e pretendimeve financiare dhe e çështjeve të pronës midis dy vendeve. Mirëpo drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, u ka thënë mediave në Bruksel se gjatë këtij takimi ata kanë ngritur çështjen e formimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

BRUKSEL, 29 TETOR - Me ndërmjetësim të Emisarit Special të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, delegacioni i Kosovës, i prirë nga koordinatori shtetëror Skender Hyseni, ka zhvilluar të enjten në Bruksel takimin e radhës me delegacionin e Serbisë. Sipas një njoftimi të Qeverisë së Kosovës, temë e diskutimit ishte zgjidhja e pretendimeve financiare dhe e çështjeve të pronës midis dy vendeve. “Në kuadër të kësaj teme sot është biseduar ekskluzivisht për pensionet dhe kadastrën. Përkundër diskutimit të gjatë për këto tema, ende nuk ka përaftrim të ndjeshëm të qëndrimeve. Por, megjithatë, është arritur pajtueshmëri që

diskutimi i këtij elementi të marrëveshjes së përgjithshme, pretendimeve financiare dhe e çështjeve të pronës midis dy vendeve, të vazhdohet në takimin e radhës”, ka njoftuar Qeveria e Kosovës.

Mirëpo, drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, i cili po merr pjesë në këto takime në emër të palës serbe, u ka thënë mediave në Bruksel se gjatë këtij takimi ata kanë ngritur çështjen e formimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe dhe kanë këmbëngulur për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit që, sipas tij, “është e nevojshme për vazhdimin e dialogut, por edhe për ndërtimin e besimit shumë të nevojshëm midis të dyja palëve”. “Pa formimin e asociacionit ne nuk mund të përparojmë në dialog. Ne do

të shohim se si pala e Prishtinës do të veprojë tani për këtë çështje. Ajo flet për mundësinë e formimit, siç e ka përcaktuar Gjykata Kushtetuese, e cila është e papranueshme, sepse për të nuk është rënë dakord në Bruksel, nuk është pjesë e parimeve të dakorduara në vitin 2015. Diçka që mund të quhet OJQ (Organizatë Joqeveritare) nuk na duhet. Na duhet një institucion serioz. Na duhet asociacioni i komunave me shumicë serbe me kompetenca ekzekutive”, ka thënë Petković. Sipas tij, duke formuar një asociacion të komunave me shumicë serbe populli serb në Kosovë mund të “ushtrojë të drejta

kolektive që nuk i gëzon tani”. Ai shtoi se është diskutuar edhe për pronat dhe pretendimet financiare, çështje këto që janë diskutuar edhe në takimin e kaluar. “Kemi diskutuar për pronat dhe pretendimet financiare për çka kemi këndvështrime të ndryshme por, megjithatë, të dyja palët kanë paraqitur qëndrimet e tyre”, ka deklaruar Petković, duke shtuar se ajo që është e rëndësishme për Beogradin është se sa herë që vijnë në Bruksel janë të përgatitur plotësisht me ekspertët dhe propozimet e tyre se si t'i qasen një problemi të caktuar. “Kur bëhet fjalë për pronën dhe pretendimet financiare,

ne insistuam që së pari të vendosim parime të qarta dhe mekanizmat për zgjidhjen e kësaj çështje të rëndësishme, e cila, ndër të tjera, ka rënduar marrëdhëniet tona për shumë vite”, ka thënë Petroviq. Shefi i delegacionit serb tha se në mënyrë që të normalizohen më tej marrëdhëniet, është e nevojshme të diskutohen “shumë çështje të tjera që nënkuptojnë kompromis”. “Kompromisi do të thotë që të dyja palët të fitojnë ose të humbin njësoj. Pra, të takohemi diku në gjysmë të rrugës. Por, që njëra palë të fitojë gjithçka dhe tjetra të humbasë gjithçka, kjo është e papranueshme për ne”, ka thënë Petroviq.

Kuvendi dështon sërish që të votojë projektligje dhe rezoluta

PRISHTINË, 29 TETOR - Deputetët e Kuvendit të Kosovës as të enjten nuk kanë arritur që të votojnë disa projektligje për marrëveshjet ndërkombëtare. Nga seancat e kaluara, të mbajtura më 16 dhe 21 tetor, ka mbetur pa u miratuar Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit - nxitja dhe leximi i mundësive për sigurimin e ujit. Po në rend të ditës për t'u votuar ishte edhe Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për Likuiditet të Urgjencës së Infrastrukturës Vitale, që është arritur në mes të Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Në mungesë të

kuorumit, as projektligji për ratifikimin e Kontratës Financiare, ndërmjet Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan, nuk ka kaluar.

Në mesin e projektligjeve që nuk kanë marrë votat e mjaftueshme ka qenë edhe ai për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të mirë të këtij projektligji të enjten kanë votuar vetëm 31 deputetë. Ky dokument ka disa nene të cilat po i kontestohen. I pari është neni 3 që definojnë atë se çka është vlerë e luftës, pastaj neni 5 që flet për respektimin e vlerave të luftës si dhe neni 9 që flet për dispozitat ndëshkuese. Më herët edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara në



Kosovë, Philip Kosnett, pati thënë se Ligji i propozuar për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës “është mënyrë e

gabuar për të treguar respekt për UÇK-në”. Gjatë kësaj seance nuk ka kaluar as rezoluta nga raportimi i kryeministrit të

Kosovës, Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi, meqë kishte kuorum për vendimmarrje.

Flet për “Epokën e re”, Shaip Kamberi

QEVERIA QË KA MINISTËR VULININ, S’MUND TË SJELLË ASGJË TË RE

Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka bërë me dije se gjendja e shqiptarëve në Luginë të Preshevës është përkeqësuar. Ai e ka kritikuar qeverinë

e re të Serbisë, duke thënë se shqiptarët nuk kanë ndonjë pritje nga ajo. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se në një qeveri në të cilën janë njerëzit si

Aleksandër Vulin, nuk mund të sjellë asgjë të re. Sipas tij, as opozita e cila i ka bojkotuar zgjedhjet nuk paraqet ndonjë opsion të qartë të shkëputjes reale nga politikat e kaluara

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 29 TETOR - Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka deklaruar se nuk ka ndonjë pritje nga qeveria e re e Serbisë, e cila është votuar të mërkurën në Kuvendin e Serbisë. Ai ka deklaruar se në një qeveri në të

cilën janë njerëz si Aleksandër Vulini, nuk mund të sjellë asgjë të re.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka deklaruar se as qeveria e kaluar nuk ka bërë asgjë për shqiptarët. “S’ka pritje nga një qeveri e cila u deklarua se do të jetë continuitet i të kaluarës. Për katër vjet nuk bëri asgjë për

shqiptarët. Madje gjendja është keqësuar. Një qeveri në të cilën janë njerëz si Vulini, nuk mund të sjellë asgjë të re”, ka thënë Kamberi. Ai ka bërë me dije se as opozita serbe e cila i ka bojkotuar zgjedhjet e fundit nuk paraqet ndonjë opsion më ndryshe se pushteti lokal. Kamberi ka deklaruar se opozitë në kuvendin serb në

katër vjetët e ardhshëm do të jenë vetëm tre deputetë shqiptarë dhe tre boshnjakë. “Jemi gjashtë, tre shqiptarë dhe tre boshnjakë nga SDA. Opozita në Serbi ka bojkotuar zgjedhjet, por as ajo nuk ka ndonjë opsion të qartë të bërjes së shkëputjes reale nga politikat e kaluara”, është shprehur ai. Ndër të tjera, Kamberi ka folur

edhe për fjalimin e tij në fuqishëm të mbajtur në parlamentin serb, ku ka kritikuar ashpër presidentin, kryeparlamentarin dhe kryeministren serbe. Ai ka deklaruar se shteti serb ende po vazhdon t’u bishtnojë marrëveshjeve politike me shqiptarët. “Për 19 vjet me radhë, pas përfundimit të luftës

së UÇPMB-së, Serbia po iu bishtnon marrëveshjeve politike me shqiptarët kur duhet avancuar të drejtat tona në arsim, kulturë, informim, përdorim zyrtar të gjuhës e shkrimit dhe simboleve kombëtare. Po pasivizon vendbanimet e qytetarëve dhe po ndikon në ndryshimin artificial të strukturës demokratike të popullsisë”, është shprehur ai, duke shtuar se gjendja jo e mirë e shqiptarëve në këtë shtet e ka shtyrë ta mbajë atë fjalim. “Ministrat serbë përdorin

Ai ka treguar se deri më tani nuk ka pasur ndonjë reagim apo kërcënim nga pushteti serb për këtë fjalim. “Do të ishin të çmendur tërësisht nëse fillojnë kërcënimet. Mendoj se e kanë të qartë se ajo nuk është rrugë për ta ndaluar zërin tonë. Daçiçi i revoltuar kërcënoi se mund të më shqiptojë dënim për shkelje të dinjitetit të parlamentit. Le ta bëjë, ta dëshmojë intolerancën edhe në atë sallë në të cilën, prej 250 vetave, vetëm 6 deputetë janë pakicë. Ajo që mund të bëjnë është të më ndalojnë pjesëmarrjen në disa seanca. Por, jam i bindur se nuk kanë hapësirë të shkojnë në atë ekstrem”, ka thënë Kamberi.

Të mërkurën, ditën që është votuar Qeveria e re e Serbisë, Kamberi në Kuvendin e Serbisë kishte kritikuar pushtetin serb. Sipas tij, pushteti aktual nuk dallon shumë nga ai i Mollosheviqit. “Ndryshe nga kryeministrja, parlamenti është i ri. I veçantë. Se opozita e vetme parlamentare është grupi i deputetëve të Luginës së Bashkuar dhe SDA-Sanxhakut. Kush do ta kishte menduar se një ditë, opozitën parlamentare në Serbi do ta përfaqësonin vetëm deputetët shqiptarë të Luginës së Preshevës dhe boshnjakët e Sanxhakut? Një opozitë me 6 deputetë prej 250. Trishtuese. Një parlament të tillë nuk e prodhoi as Slllobodan Millosheviqi. Po ja që z. Vuçiçi dhe z. Daçiçi po dëshmojnë më efikas se baballarët e tyre ideopolitikë”, kishte thënë Kamberi në fjalimin e tij.

Gjithashtu, në fjalimin e tij ai ka përmendur edhe krimet që Serbia i ka kryer gjatë luftës në Kosovë. “Nga një Serbi ku shteti mbron Ljubisha Dikoviçin dhe Bozhidar Deliqin, si të pritët njohja e krimeve të luftës ndaj civilëve në Reçak, Mejë, Korenicë, Qyshk etj? Por, ja që sot na thuhet se po themelohet një qeveri progresive. Më demokratikja e historisë së Serbisë. Meqë qenka kështu, ftoj kreun e kësaj qeverie, zonjën Bërnabiq, për një vizitë të përbashkët. Meqë nuk e pashë në ekspozitën e pardjeshme të fotografive të krimeve të luftës në Kosovë, vetëm disa qindra metra larg nga kjo sallë, ftoj zonjën Bërnabiq që ta vizitojmë nesër bashkërisht Batajnicën, ku në varreza masive gjenden viktimat civile që i cilësoni edhe sot si shtetas tuaj”, ka thënë ai, duke e ftuar kryeministren Bërnabiq të dallojë nga shefat e saj.

Kosova dhe Hungaria nënshkruajnë marrëveshje të reja, rritet edhe numri i bursave për studentët e Kosovës

BUDAPEST, 29 TETOR (ER) - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, të enjten është prituri në takim nga homologu i vet, ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë i Republikës së Hungarisë, Peter Szijjarto, me të cilin ka zhvilluar diskutime gjithëpërfshirëse dhe ka nënshkruar dy marrëveshje që thellojnë edhe më tej marrëdhëniet e mira midis dy vendeve. “Pata nderin dhe kënaqësinë e madhe të zhvilloja një takim gjithëpërfshirës me ministrin Szijjarto, gjatë vizitës zyrtare në Budapest. Nënshkruam dy marrëveshje bilaterale: Mbrojtjen dhe Promovimin e Investimeve dhe Programin e Koordinimit për Shkencën dhe Edukimin”, ka thënë Haradinaj-Stublla.

Me këtë rast, kryediplomatja e Kosovës dhe homologu i saj hungarez nënshkruan edhe memorandumimin e mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e Edukimit dhe të Shkencës për ofrimin e skemës

së bursave “Stipendium Hungaricum”, duke ngritur kështu numrin e bursave të ofruara nga Hungaria për studentët kosovarë nga 50 në 75 për tri nivele të studimeve.

E shoqëruar nga deputetja, njëherësh kryetarja e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, Time Kadrijaj dhe ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ministrja Haradinaj-Stublla i shprehu homologut hungarez mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Hungarisë dhënë Republikës së Kosovës, subjektivitetit të saj ndërkombëtar dhe aspiratës Euro-Atlantike. Nga ana e tij, ministri Szijjarto ka shprehur mbështetjen e plotë dhe të rezervë për të drejtën e vonuar të Kosovës për liberalizim vizash, duke ftuar të gjitha shtetet e BE-së për veprim strategjik dhe vendim-marrje finale, tani gjatë Presidencës Gjermane me Bashkimin Evropian.

Gjatë vizitës zyrtare në Hungari, ministrja Haradinaj-

Stublla është takuar edhe me kryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme në Parlamentin Hungarez, Zsolt Nemeth.

Në këtë takim u shkëmbyen pikëpamjet rreth bashkëpunimit bilateral Kosovë - Hungari, duke vënë theksin edhe në zhvillimet politike në rajon, specifikisht temën e dialogut me Serbinë. “Shpreha vendosmërinë e Kosovës për të arritur marrëveshje përfundimtare të njohjes reciproke në kufijtë ekzistues me Serbinë, vetëm duke respektuar tri parimet e panegociueshme: integritetin territorial, rendin kushtetues dhe karakterin unitar të Republikës së Kosovës”, ka thënë ajo.

Edhe në këtë takim të dyja palët janë pajtuar të vazhdojnë punën e përbashkët ndër-shtetërore për thellimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Hungarisë, veçanërisht përmes formalizimit të Grupit të Përbashkët Parlamentar të Miqësisë Kosovë - Hungari.




terminologji fyese kundrejt shqiptarëve. Një revoltë e grumbulluar, por jo vetëm me pushtetin e Beogradit dhe me bashkësinë ndërkombëtare e cila po bën sehir për gjithë këtë. Prandaj, u dashtë që në vendin e duhur, prej nga dëgjohe zëri gjithkund, gjërat të emërohen ashtu siç janë”, ka deklaruar Kamberi.

Demokrasi Plus: OShP-ja 'përdor' pandeminë për të mos mbajtur seancaa

PRISHTINË 29 TETOR (ER) - Demokrasi Plus (D+) ka reaguar ndaj Organit Shqyrtues të Prokurimit (OShP) i cili, për shkak të pandemisë Covid-19, nuk është duke i mbajtur fare seancat me palët dhe publikun dhe në këtë formë është duke e dëmtuar seriozisht integritetin e procesit të shqyrtimit të ankesave. "Mosmbajtja e seancave me palët në kuadër të shqyrtimit të ankesave u pamundëson palëve ballafaqimin e argumenteve ndërmjet tyre dhe kundërshtimet e ekspertizave gjë që paraqet thelbin e shqyrtimit të ankesave në prokurim publik. Po ashtu, ballafaqimi i palëve është e drejtë e garantuar me Ligjin për

Procedurë të Përgjithshme Administrative. Secilës palë duhet t'i garantohet e drejta e dëgjimit pranë panelit në mënyrë që të ketë mundësi të dëshmojë se ankesa është e bazuar dhe se paneli ka dëgjuar të gjitha provat dhe pretendimet e parashtruara", thuhet në komunikatën e Demokrasi Plus.

Në praktikën aktuale, OShP-ja është duke marrë vendime vetëm në prani të panelit me arsyetimin e rrezikimit nga pandemia. "Sidoqoftë, ky arsyetim ka pasur bazë vetëm për një kohë të shkurtër dhe OShP duhet ta përdorë teknologjinë informative, apo t'i organizojë seancat me masa mbrojtëse dhe në këtë mënyrë



t'u mundësojë palëve që t'i parashtrorjnë argumentet e tyre në seancë ku i ballafaqojnë të gjitha kundërshtimet dhe pretendimet e veta. Prandaj, Demokrasi Plus i bën thirrje OShP-së që ta rikonsiderojë vendimin e saj për të mos

mbajtur seanca të hapura me palët dhe të garantojë se secili vendim i saj të nxirret vetëm pasi që palëve t'u garantohet e drejta e dëgjimit", është theksuar në këtë komunikatë. Sipas Demokrasi Plus, kjo rritë besimin në vendimet e OShP-së dhe mundëson që vendimet e panelit shqyrtues të jenë të mirinformuara dhe të bazuara në pretendimet e plota të palëve ndëranksuese. "Praktika aktuale e mosmbajtjes së seancave dëgjimore ka rritur bregën e publikut dhe sektorit privat se vendimet në OShP merren sipas dëshirës së grupeve parapolitike dhe jo sipas fakteve dhe dëshmive të dorëzuara në ankesa", është theksuar në komunikatën e Demokrasi Plus.

Gjendja me Covid, SBASHK-u nis vizitat në institucionet arsimore

SKENDERAJ, 29 TETOR (ER) - Për ta parë nga afër gjendjen aktuale të institucioneve arsimore në tërë Kosovën, përfaqësuesit e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, koordinatori për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor Blendor Shatri e kanë nisur agjendën e vizitave nëpër komunat e Kosovës. Vizitën e parë e kanë bërë në Komunën e Skenderajt dhe fillimisht kanë zhvilluar një bashkëbisedë me drejtorin e arsimit, Bekim Latifi dhe kryetarin e nivelit komunal sindikal, Ramiz Polaci, për t'u informuar për gjendjen aktuale dhe për rrjedhën e procesit mësimor në institucionet arsimore këtu. Ata pastaj bashkërisht janë takuar me kryetarin e Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari. Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, ka falënderuar kryetarin e Skenderajt për

gjithë angazhimet në shërbim të arsimit dhe plotësimin të kërkesave për punëtorët arsimorë që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës. "Agjendën e vizitave nëpër komuna e kemi nisur këtu për ta shprehur respektin për përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm në shërbim të arsimit të drejtorit të DKA-së së Skenderajt, Bekim Latifi, të kryetarit të nivelit sindikal komunal Ramiz Polaci, por për të shprehur respekt meritore edhe për ju", është shprehur në fillim të takimit me kryetarin Bekim Jashari, kryetari i SBASHK-ut, duke shtuar se po ndihen krenarë që po takohen e po bashkëbisedojnë lirshëm me një pjesëtar të familjes embleme për gjithë shqiptarët. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka shprehur respekt për angazhimet e SBASHK-ut dhe ka vlerësuar lart edhe bashkëpunimin në shërbim të



arsimit të nivelit komunal të SBASHK-ut me DKA-në dhe me institucionet e tjera në këtë komunë. Në kuadër të kësaj bashkëbisede është vlerësuar se

në Skenderaj është gjendja stabile edhe në procesin mësimor. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, bashkë me drejtorin e DKA-së dhe

kryetarin e nivelit komunal sindikal, kanë vizituar shkollën e cila mban me krenari emrin e mësuesit dhe të heroit të kombit Shaban Jashari.

Punëtorët shëndetësorë do të marrin pagesa shtesë deri në fund të këtij viti



PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe përfaqësuesit e Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës (FSShK), të udhëhequr nga kryetari dr. Blerim Sylja, së bashku me nënkryetarët mr. Blerim Delija dhe dr. Xhemajl Selmani, u pajtuan për pagesat shtesë për të punësuarit në institucionet publike shëndetësore të Republikës së Kosovës, në

sistemin primar, sekondar dhe terciar, deri në fund të vitit 2020, bazuar në Ligjin anti-Covid.

Duke marrë në konsideratë mundësitë financiare që Qeveria e Republikës së Kosovës ka në këtë periudhë, për t'i mbështetur të punësuarit në sistemin publik shëndetësor, palët u morën vesh që pagesat shtesë për muajt shtator-dhjetor të jenë si në vijim: 1. Mjekët - 250 euro në muaj, 2. Infermierët - 150

euro në muaj, 3. Staf mbështetës - 100 euro në muaj.

Kryeministri Hoti është zotuar se qeveria në afat shumë të shkurtër kohor do t'i kryejë edhe pagesat shtesë për stafin mbështetës për muajt korrik dhe gusht të këtij viti. Palët, po ashtu, janë marrë vesh që në fillim të vitit të ardhshëm të diskutojnë për mundësitë për pagesat shtesë për kohën sa do të zgjasë pandemia me Covid-19 në territorin e Kosovës.

2 869 raste aktive me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka raportuar të enjten për 284 persona të infektuar me Covid-19, ndërkaq gjatë 24 orëve të fundit është shënuar edhe një vdekje. Rezultatet e të infektuarve janë në bazë të 1 058 mostrave të testuara. Sipas njoftimit të IKShPK-së, gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar edhe 72 pacientë, ndërsa raste aktive janë 2 869

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 1 058 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 284 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me

Covid-19.

Numri total i rasteve pozitive është 18 910 raste nga 91 098 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 674 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 72 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve deri më sot është gjithsej 15 367 raste, kurse numri i rasteve aktive është 2 869.

Rastet e fundit pozitive janë nga: komuna Prishtinë 117 raste, komuna Gjakovë 28 raste, komuna Ferizaj 19 raste, komuna Fushë-Kosovë 19 raste, komuna Podujevë 18 raste, komuna Pejë 12 raste, komuna



Vushtrri 11 raste, komuna Drenas 8 raste, komuna Mitrovicë 7 raste, komuna Shtime 6 raste, komuna Obiliq 5 raste, komuna Prizren 5 raste,

komuna Junik 4 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Kamenicë 3 raste, komuna Rahovec 3 raste, komuna Suharekë 3 raste, komuna Deçan

2 raste, komuna Gjilan 2 raste, komuna Klinë 2 raste, komuna Lipjan 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Han i Elezit, Istog dhe Malishevë.

Miratohet plani për parandalim dhe kontroll të Covid-19

Komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë ka miratuar të enjten planin për parandalim dhe kontroll të Covid-19 (nëntor-prill 2021), versionin 2.0. Në takimin e Komitetit mori pjesë edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili i falënderoi anëtarët e Komitetit për hartimin e këtij plani, që është përditësuar i planit për gatishmëri dhe reagim kundër Covid-19, dhe punonjësit

e IKShPK-së për angazhimin e tyre në kontrollin e situatës epidemiologjike lidhur me Covid-19.

Ministri Zemaj ka thënë se situata aktuale kërkon një angazhim dhe përkushtim shtesë për ta kontrolluar situatën, ndërsa qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë do ta mbështesin punën e profesionistëve shëndetësorë në angazhimin e tyre për gjurmimin e rasteve me

Covid-19, testimin e tyre dhe trajtimin klinik. "Jemi në një moment kur rastet kanë shënuar rritje kudo, prandaj nga ne kërkohet që t'i vazhdojmë angazhimet sikurse deri më tani për ta mbajtur situatën nën kontroll", ka thënë ministri Zemaj.

Drejtori ekzekutiv i IKShPK-së, Naser Ramadani, ka thënë se plani për parandalim dhe kontroll të Covid-19 (version 2.0)

përshin strategjinë e veprimit: gjej, testo, gjurmo, izolo me ofrim të testeve laboratorike (publik dhe privat), përfshirje të organizatave të sektorit publik dhe privat dhe sigurimin e të gjitha burimeve të nevojshme për ta mundësuar zbatimin e planit për parandalim dhe kontroll të Covid-19.

Aspekte të hollësishme të planit ka prezantuar dr. Ariana Kalaveshi, udhëheqëse e

Departamentit të Epidemiologjisë në IKShPK. Planin i miratuar nga Komiteti për Monitorimin e Sëmundjeve Ngjitëse ka pesë pjesë të ndërlidhura mes vete siç janë: planifikimi dhe parashikimi, monitorimi i situatës dhe vlerësimi i riskut, menaxhimi i riskut dhe koordinimi, organizimi institucional, hulumtimi dhe reagimi si dhe komunikimi dhe komunikimi i riskut.

Reforma e administratës publike në linjë me raportin e KE-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 TETOR - Kryeministri Avdullah Hoti ka marrë pjesë të enjten në tryezën e diskutimit me organizatat e shoqërisë civile, me temën "Reforma e Administratës Publike: Shtytja e saj përpara". Kryeministri Hoti ka nënvizuar faktin se Republika e Kosovës është në proces të ndërmarrjes së veprimeve konkrete sa i përket reformës administrative që duhet të ndodhë. "Javën që shkoi është miratuar dokumenti për reduktimin e barrës administrative, i cili është në linjë me sugjerimet që i kemi marrë edhe në raportin për Kosovën nga Komisioni Evropian", ka theksuar Hoti. Ai ka vlerësuar se Kosova ka nevojë ta rrisë efikasitetin institucional, në mënyrë që të mundësohet kursimi i parasë

publike, të ulen shpenzimet publike, të ulen kostot e qytetarëve dhe bizneseve, si dhe të rritet ekonomia e vendit.

Ndërkaq zëvendëskryeministri Besnik Tahiri, si i ngarkuar me procesin e reformës së administratës publike, pasi shpallosi pikat kryesore të planit të punës, ka theksuar se ky program është një përpjekje e vazhdueshme me qëllim të përfitimit për qytetarët.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka shprehur konsideratën dhe vlerësimin e tij më të lartë për punën, profesionalizmin dhe qasjen korrekte për trajtimin e çështjeve dhe temave që janë cekur në këtë raport, në veçanti të dalat dhe rekomandimet sa iu përket reformave në administratë publike (RAP). Ai ka theksuar e aprovimi i pakos ligjore për



reformën e administratës publike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shënoi kulmimin e viteve të tëra të përpjekjeve për të krijuar një reformë gjithëpërfshirëse të shërbimit civil dhe të administratës

shtetërore. "Këto ligje krijojnë një sistem krejtësisht të ri të procedurave të rekrutimit dhe avancimit në shërbimin civil, duke iu bërë ballë në masë të madhe ndërhyrjeve politike në këtë proces, përmes vendosje së

një sistemi të unifikuar për mbi 82 mijë nëpunës që janë të punësuar në sektorin publik, si dhe e rritë llogaridhënien e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura", ka thënë ministri Veliu.

Hoti flet para kompanive amerikane për planet e zhvillimit ekonomik

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, gjatë një takimi me kompanitë amerikane që operojnë në vendin tonë, ka thënë se planifikohet që në një periudhë nga pesë deri në shtatë vjet ekonomia e Kosovës të transformohet në një qendër të komunikimit rajonal



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 TETOR - Kompanitë amerikane që operojnë në Kosovë u takuan të enjten me kryeministrin e Kosovës, Avdullah Hoti, për të diskutuar për planet për zhvillim ekonomik të vendit, duke përfshirë lehtësimin e procedurave burokratike dhe lehtësirat e tjera të mundshme që do ta përmirësonin klimën e të bërit biznes në vend. Në këtë takim të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë morën pjesë përfaqësues të kompanive Coca Cola HBC, Microsoft, Cisco, dhe Stone Castle, si dhe ish-kongresmeni amerikan, i nderuari Jerry Weller. Kryeministri Hoti ka shpalosur planet e qeverisë për krijimin e

një mjedisi konkurrues të të bërit biznes në vend, kurse ka theksuar se rëndësi e veçantë po i kushtohet zbatimit të projekteve që burojnë nga Marrëveshja e Uashingtonit, të cilat do të mund të krijojnë efekte multiplikative në ekonominë e vendit. Sipas kryeministrit Avdullah Hoti, planifikohet që në një periudhë nga pesë deri në shtatë vjet ekonomia e Kosovës të transformohet në një qendër të komunikimit rajonal. Për më tepër, kryeministri Hoti ka potencuar se qeveria në bashkëpunim me Bankën Botërore po punon për ta zvogëluar barrën administrative për bizneset, duke rishikuar një numër ligjesh dhe duke thjeshtësuar procedurat burokratike për të gjithë sektorët ekonomikë. Ai

ka shtuar se është e domosdoshme të krijohen kushtet e nevojshme në tërë rajonin për t'i tërhequr investitorët e huaj të cilët tashmë po largohen nga lindja e largët. Ish-kongresmeni amerikan, i nderuari Jerry Weller, foli për nevojën e zhvillimit të një

programi qeveritar në mbështetje të sektorit të prodhimit dhe eksporteve, marrë parasysh faktin se sistemi amerikan i preferencave për prodhim dhe eksport, ku përfshihet edhe Kosova, skadon këtë vit. Ndërsa përfaqësuesit e kompanive

amerikane, anëtare të Odës Ekonomike Amerikane, patën mundësinë t'i adresonin nevojat dhe kërkesat e sektorëve në të cilët ata veprojnë, si dhe t'i ofronin rekomandimet e tyre për hapat që mund të ndërmerren drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes në Kosovë.

Veseli viziton fabrikën e investitorëve nga diaspora që do të punësojë 150 qytetarë

KAÇANIK, 29 TETOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka qëndruar në Komunën e Kaçanikut, ku bashkë me kryetarin e komunës, Besim Ilazi, kanë vizituar disa biznese për t'u njoftuar nga afër mbi sfidat dhe punën e tyre në kohë pandemie. Lideri i PDK-së ka vizituar një fabrikë betoni e cila po ndërtohet në Kaçanik nga investitorë shqiptarë të diasporës e ku do të punësohen më shumë se 150 punëtorë. Me këtë rast, Veseli ka përgëzuar kryetarin e komunës për bashkëpunimin me investitorët për krijimin e kushteve për hapjen e fabrikës. "Unë ndihem shumë krenar me punën shembull të kryetarit Besim Ilazi në Kaçanik, e cila është



pikërisht ajo që i duhet Kosovës, çka i duhet rinisë dhe që është edhe politikë e imja si kryetar i PDK-së. E ky pra është punësimi i të rinjve, punësimi i

njerëzve tanë në Kosovë. Është një shembull i jashtëzakonshëm se si qeverisja komunale u ofron investitorëve tanë. Kijeni parasysh, Zharku

dhe Guri janë dy familje që po investojnë kapitalin e tyre prej miliona euro duke sjell investime në vendlindjen e tyre. I falënderoj për këtë investim ku

do të punësohen rreth 150 qytetarë. Kjo është fabrikë që do të prodhojë për Kosovën, për eksport dhe kjo është ajo që i duhet Kosovës", ka deklaruar Veseli.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut, Besim Ilazi, tha se Kuvendi Komunal i ka siguruar parcela në shfrytëzim për 99 vjet investitorëve nga diaspora ku do ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendlindjen e tyre dhe ku do të hapin shumë vende të reja pune. Edhe përfaqësuesi i kompanisë investuese tha se fabrika e tyre është fabrikë betoni e cila do të prodhojë elemente të para fabrikua të betonit. Ai tha se ky investim është nga diaspora dhe udhëhiqet nga bashkatdhetari Mevlud Zharku, i cili një kompani të ngjashme betoni e ka edhe në Gjermani.

"Vala" reagon ndaj sms-ve mashtrues: Injoroni, mund të dëmtoheni

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Përdoruesit e operatorit të telefonisë mobile "Vala" po ballafaqohen me mesazhe mashtruese. Kohën e fundit, në adresë të konsumatorëve të "Valës", janë dërguar mesazhe të cilat shpallin fitues të qindra mijëra dollarëve, duke iu kërkuar edhe të dhënat personale. "You Won \$750,000. From

Samsung. Send Your Address to : samsungdept24@gmail.com", shkruhet në mesazhet e pranuar nga konsumatorët të "Valës". Ndaj këtyre mesazheve ka reaguar "Vala", e cila ka kërkuar nga konsumatorët që të mos mashtrohen nga mesazhet që mund t'ju shpallin fitues të lojërave shpërblyese. "Këta

'sms', sipas 'Valës', mund të jenë mashtrime dhe mund të dëmtoheni. I nderuar konsumator, mos u mashtroni nga sms që mund t'ju shpallin fitues të lojërave shpërblyese duke ju kërkuar të dhënat personale. Këta sms mund të jenë mashtrime dhe ju mund të dëmtoheni. Thjesht injoroni këta SMS", thuhet në reagimin e "Valës".



Ministri Arban Abrashi dhe Blagoj Boçvarski merren vesh për projekte të përbashkëta infrastrukturore

Kosova dhe Maqedonia e Veriut së shpejti me pikë të përbashkët kufitare

Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, pas takimit me ministrin e Transportit të Maqedonisë së Veriut, Blagoj Boçvarski, ka thënë se Kosova dhe Maqedonia e Veriut së shpejti do të arrijnë marrëveshje për krijimin e një pike të përbashkët kufitare që mundëson lehtësimin e qarkullimit të mallrave dhe të qytetarëve ndërmjet këtyre dy shteteve



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 TETOR - Ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, të enjten ka pritur në takim ministrin e Transportit të Maqedonisë së Veriut, Blagoj Boçvarski. Në këtë takim njoftues, ministrat e të dy shteteve diskutuan rreth punëve të përbashkëta që do të realizojnë shumë shpejt. Abrashi tregoi se janë pajtuar për pikën e përbashkët kufitare që do ta shkurtojë kohën e pritjes së qytetarëve dhe transportit të mallrave. Pikë të përbashkët Kosovë - Maqedoni do të ketë edhe në transportin hekurudhor, për elektrifikimin e së cilës do të konkurrojnë bashkë në fonde të

Bashkimit Evropian. Ministri Abrashi ka bërë me dije se në Strezemir të Dragashit infrastruktura rrugore nga ana e Republikës së Kosovës është duke përfunduar, kur edhe do të hapet pika e re kufitare me Maqedoninë e Veriut. Krahas këtyre, Abrashi ka thënë se janë në prag të fillimit të fizibilitetit për rrugën Prizren-Tetovë dhe në bisedime për realizimin e projektit për gazsjellësin. Homologu i tij maqedonas, Blagoj Boçvarski, tregoi se janë duke punuar me plan dinamik për realizimin e pjesës së mbetur të autostradës "Arbën Xhaferi", e cila pritet të përfundojë në vitin 2022. Ai ka thënë se janë në fazën e parë të punimeve të kësaj autostrade në

anën e tyre dhe kap shifrën 110 milionë euro. Ky takim i paraprind mbledhjes së përbashkët të të dyja qeverive,

për konkretizim më të mirë të projekteve. Po ashtu, të dy ministrat u morën vesh që ta krijojnë një ekip të përbashkët

për realizimin e projekteve infrastrukturore në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Shefi i BE-së në Kosovë ngrit shqetësimin për vjedhjen e mbi 2 milionë eurove



PRISHTINË, 29 TETOR - Shefi i zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, ka ngritur shqetësimin për vjedhjen e mbi 2 milionë eurove nga Thesari i Shtetit. Szunyog gjatë një diskutimi me organizatat e shoqërisë civile, ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet ta zbatojë racionalizimin e agjencive dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët. "Pas këtij viti nuk kemi parë ndryshime në aspektin se si administrata është organizuar. Më shumë kohë është dashur t'i kushtohet për të organizuar rreziqet që paraqiten në organizimin e tanishëm të

keqpërdorimit të financave publike. Vetëm në javën e fundit patëm rastin kur dy milionë euro i vodhën nga Thesari. Po ashtu, ligji përcakton bashkëpunimin ndërinstucional dhe ministrat mund ta organizojnë ofrimin e shërbimeve", u shpreh Szunyog. Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, kishte sqaruar keqpërdorimin prej dy milionë eurosh në Thesarin e Shtetit, të cilat janë transferuar te një operator ekonomik. Sipas saj, janë kryer katër transaksione, ku është arrestuar dhe është suspenduar një zyrtar i ministrisë. "Bëhet fjalë për katër

transaksione të dyshimta nga Thesari i Shtetit dhe janë transferuar mbi 2.1 milionë euro. Janë bartur në një xhirrollogari të një operatori ekonomik. Janë mbi dy zyrtarë të dyshuar, njëri është arrestuar, tjetri është suspenduar. Kemi gjurmuar të gjitha transaksionet dhe jemi duke hetuar ku është transaksioni fundor. Është rast i izoluar. Mjetet dhe buxheti i Kosovës është stabil. Gjithçka po gjurmohet sepse është transaksion bankar e nuk janë tërhequr mjetet. Të gjitha gjurmët janë në Bankën Qendrore të Kosovës", kishte thënë Bajrami.


Pas reagimeve të OAK-së, rregullohen IP adresat

PRISHTINË, 29 TETOR (ER) - Oda e Afarizimit e Kosovës (OAK) ka reaguar lidhur me problemet e IP adresave që dëmtonin me miliona euro biznesin dhe buxhetin e Kosovës. Me këtë rast i dëmtuar ka qenë edhe sektori medial, ku në çdo portal që ka paraqitur reklama në fund të faqes në bazë të IP-ve janë shfaqur reklamat në gjuhë të huaja dhe jo në gjuhën

shqipe. Sipas kësaj ode, kjo ka ndikuar negativisht në sektorin e biznesit medial dhe e ka dëmtuar atë jashtëzakonisht shumë. "Për këtë arsye Oda e Afarizimit e Kosovës (OAK) ka organizuar edhe takime ndërinstucionale, në mesin e të cilave edhe me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me anëtarët e bordit të Autoritetit

Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Si rezultat i këtyre takimeve, me kënaqësi ju njoftojmë se tashmë një problematikë e tillë është rregulluar, pas shqetësimit dhe reagimeve të bëra nga OAK-u. Rikujtojmë se më parë, nëse kemi kërkuar për IP adresën tonë, pavarësisht se ne jemi gjendur në Kosovë, ka figuruar se

gjendemi në Mal të Zi, Serbi apo edhe në ndonjë vend tjetër të rajonit ose nuk e ka identifikuar fare IP adresën tonë, ndërsa tani figuron Kosovë apo Shqipëri", është thënë në komunikatën e OAK-ut. OAK-u konsideron se problemi i mëhershëm me IP adresat e ka dëmtuar edhe vetë imazhin e shtetit të Kosovës.



Lladrovci pret në takim një delegacion investitorësh potencialë

DRENAS, 29 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim investitorët potencialë Christophe François Darbord, Joel Jacques Jean dhe Blerim Hoxha. Takimi është mbajtur me qëllim të njohjes së ndërsjellë dhe shkëmbimit të informacioneve për aktivitetin ekonomik dhe për mundësinë e investimeve strategjike në Komunën e Drenasit.

Kryetari Lladrovci u ka ofruar vizitorëve një dosje me tërë legjislacionin e nevojshëm për investime strategjike dhe i ka njoftuar ata për mundësitë për investime, lehtësirat për investitorët e huaj dhe për qasjen pozitive që kjo komunë ofron për investimet e huaja serioze me interes strategjik. Pas takimit, Lladrovci u ka dhuruar vizitorëve medaljonet



e punuara nga anëtarët e QPDG-së dhe pastaj vizitorët kanë bërë homazhe pranë shtatoreve të heronjve Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

Pastaj ata kanë vizituar Prekazin, ku janë pritur nga kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari dhe pasi kanë bërë homazhe në

kompleksin memorial "Adem Jashari", kryetari Jashari i ka njoftuar për historinë e familjes dhe luftën për lirinë e vendit. Vizita e këtij

delegacioni është përmbyllur me homazhet në Gllanasellë dhe me një drekë pune në ambientet e shtëpisë së kryetarit Lladrovci.

Komuna e Prizrenit fillon aksionin për mbledhjen e mbeturinave të vëllimshme

PRIZREN, 29 TETOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se sektori i menaxhimit të mbeturinave në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, nga 1 deri më 7 nëntor do ta realizojë aksionin vjeshtor të mbledhjes së mbeturinave të vëllimshme nga të gjitha amvisëritë. Mbeturinat e vëllimshme llogariten të gjitha gjësendet e vjetërsuara që nuk përdoren, duke përfshirë orendi të vjetra

shtëpiake, vitrina, set ulësesh, tepihë, pajisje teknike etj. "Ky aksion realizohet sipas orarit të rëndomtë të mbledhjes së mbeturinave. Shtëpitë private këto mbeturina duhet t'i vendosin para dyerve, në ditën kur bëhet shërbimi për mbledhjen e mbeturinave në lagjen përkatëse. Ndërsa banimet kolektive duhet t'i vendosin ato në pikën publike më të afërt të grumbullimit të

mbeturinave. Mbeturinat e vëllimshme nuk duhet të hidhen në çdo kohë! Shërbimi është pa pagesë dhe bëhet vetëm dy herë në vit. Lusim qytetarët që ta respektojnë orarin e mbledhjes së mbeturinave dhe për çdo informatë shtesë të lajmërohen në sektorin e menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Prizrenit, në numrin e telefonit 038/200 44 750", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Fillon riparimi i lapidarëve të dëshmorëve në Astrazup, Dragobil dhe Balincë

MALISHEVË, 29 TETOR (ER) - Të enjten kanë filluar punimet për riparimin e lapidarëve të dëshmorëve të kombit në Astrazup, Dragobil dhe Balincë të Malishevës. Këto punime i kanë inspektuar drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, kryetari i shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, Dega në Malishevë, Metush Kryeziu me bashkëlufëtarët, Nuhi Shala dhe Sejdi Paçarizi. Me këtë rast, drejtori Morina ka thënë se e kanë obligim kombëtar që të përkujdesen për t'i ruajtur vlerat e luftës çlirimtare. "Institucionet e Komunës së Malishevës dhe shoqatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Malishevë në prag të

festave të nëntorit e kanë prioritet riparimin e lapidarëve të dëshmorëve në territorin e Malishevës dhe obligim kombëtar e historik për këto shenja të kujtesës sonë kombëtare që me jetën dhe gjakun e tyre dhe të bashkëlufëtarëve Kosovës ia sollën lirinë", ka thënë Morina. Në vazhdim të punimeve do të riparohen edhe lapidarë dhe memoriale të tjera të luftës së UÇK-së në hapësirën territoriale të Komunës së Malishevës dhe institucionalisht do të përkujdesem për këto vlera kombëtare, që brezat e rinj të njihen e mësojnë për sakrificën e tyre që dhanë për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Mbledhja e mbeturinave të vëllimshme

Sakupljanje obimnog otpada / Hacimli atik toplaması

1-7 NËNTOR / NOVEMBRA / KASIM



AKSION VJESHTOR
JESENJSKA AKCIJA / SONBAHAR EYLEMI

SHËRBIMI BËHET VETËM DY HERË NË VIT

USLUGA JE SAMO DVA PUTA GODIŠNJE I BEZPLATNO
BU HİZMET YILDA İKİ DEFA DİZENLENİR VE HİZMET ÜCRETİ YOKTUR



Sektor i menaxhimit të mbeturinave / Sektor za Upravljanje Otpadom / Atik Yönetimi Sektörü **2020**



AJO KOHË DHE KJO KOHË

Nga Xhavit ALIU



1. Kur isha student, gjatë viteve '90, shqetësim kryesor kishim çlirimin nga okupatori serb, që kishte pushtuar gjithë Kosovën. Kudo dhunë, kudo shkelje e të drejtave të njeriut. Edhe atë pak autonomi që kishim, e suprimuan me dhunë dhe terror të paparë, me tanke, me bajoneta. Të ishe student në atë kohë ishte sakrificë, sepse çdo ditë e jona ishte e pasigurt, ishte përballje me regjimin policor të kryekriminalit Millosheviq. Bodrumet u bënë shkolla, ku fshehurazi të rinjtë shqiptarë të Kosovës merrnin dituri. Nga bodrumet e asaj kohe rinia studentore, së bashku me profesorët, ditën të organizoheshin, duke mbajtur gjallë universitetin dhe frymën atdhedashëse dhe liridashëse. Padyshim, profesorët dhe arsimtarët e viteve '90 ishin heronjtë e gjallë të Kosovës. Ideali i madh e mbante gjallë popullin martir të Kosovës. Nuk po e zgjas shumë për atë kohë sepse për t'i përshkruar mundimet e asaj kohe duhet një shkrim që nuk ka kurrë fund...

2. Secili shqiptar, kudo që është, duhet ta dijë se Kosova u çlirua nga sakrificë që u bë, nga gjaku i bijve dhe bijave më të mirë të këtij vendi, në të gjitha periudhat. Ai zjarr që u ndez në të kaluarën, shpërtheu si vullkan dhe kulmoi me luftën e lavdishme të UÇK-së, në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari. Pa UÇK-në nuk do të kishim as liri, as shtet të

pavarur. Këtë, secili nga ne mendon se e di, por jo edhe në atë masë që duhet ditur, ka të atillë që nuk duan ta dinë. E vërteta është që UÇK lindi nga gjiri i popullit të Kosovës. Edhe këtë, thjesht, mendojnë të gjithë se e dinë, por ka individë që nuk e dinë. Madje ka pretendime që ta njollosin, por i njollosuri, njollos, edhe këtë duhet ta dimë...

E vërteta e madhe është se aparati shtetëror kriminal i Millosheviqit kreu mbi 400 masakra mbi shqiptarët, civilë të pambrojtur, vrau, dhunoi, dogji, plaçkiti, dëboi me dhunë mbi 1 milion shqiptarë nga Kosova në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe tjetërsoi pronat e shqiptarëve. Kaluan mbi 20 vjet që nga paslufta dhe familjarët e të zhdururve gjatë luftës në Kosovë, nuk dinë asgjë për fatin e më të dashurve të tyre. Prandaj, dialogu me Serbinë do të duhej të kushtëzohej, në mënyrë të prerë, me zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

3. Rrethimi i zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së ishte për keqardhje, po ashtu arrestimet që u bënë aty më shumë ishin një spektakël neveritës. Nuk ka pasur nevojë për një ndërhyrje të tillë, sepse luftëtarët e lirisë, sa herë që është kërkuar, iu kanë përgjigjur gjykatave ndërkombëtare, duke dalë gjithherë faqebardhë para drejtësisë. Çlirimtarët mbeten çlirimtarë përgjithmonë, pa

marrë parasysh furtunat e kohës dhe të armikut. Por një gjë duhet ditur, siç thotë populli: "Uji fle, armiku nuk fle". Edhe këtë mendojmë të gjithë se e dimë, por ka nevojë t'ia përsërisim vetvetes, sa e sa herë. Propaganda serbe nuk po ndalet asnjëherë në dëm të Kosovës dhe pjesë e kësaj propagande janë bërë edhe ca media vendore, të cilat, me vetëdije apo pa vetëdije, çojnë ujë në mullirin e armikut. Pra, disa shpirtngushtë, të verbuar nga etja për pak pushtet, janë në gjendje të bëjnë gjithçka, qoftë edhe për ta mohuar luftën e lavdishme të UÇK-së. Pra, me sa po shihet, problemi nuk është edhe aq i thjeshtë, sepse Serbia ka futur në funksion fundërrinat e deridjeshme të tyre, për të njollosur çdo gjë, qoftë edhe vlerën më sublime që ka pasur ndonjëherë ky popull, UÇK-në. Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri luftë çlirimtare, në aleancë me NATO-n, që ndërhyri si rezultat i gjenocidit dhe shfarosjes masive që bënte regjimi kriminal i Serbisë ndaj popullit të Kosovës.

4. Thuhet se e kaluara që harrohet, mund të përsëritet. Dashtë Zoti që ajo e kaluar e hidhur që përjetoi Kosova martire, të mos përsëritet më kurrë. Por, për ta ruajtur lirinë dhe pavarësinë e shtetit të Kosovës duhet punë e përkushtim, pa hile, nga secili. Duhet që të ketë përkushtim institucional ndaj qytetarit dhe

përgjegjësi ndaj tij. Deri më tani, këtë e kemi dëgjuar vetëm me fjalë, por jo me vepra konkrete. Ç'është e vërteta, nepotizmi, korrupsioni dhe klanet e lidhjet familjare nëpër institucione qendrore dhe lokale po e dëmtojnë rëndë këtë shtet. Përditë ndeshesh me miliona padrejtësi, në çdo hap që bën njeriu. Madje edhe ata që luftuan deri dje, të cilët gjymtyrët e trupit i lanë në fushëbeteja kundër armikut, sot nuk çmohen, përkundrazi nëpërkëmben. Nuk çmohen luftëtarët e lirisë, të cilët shumica prej tyre ose i janë kthyer profesionit të tyre, ose janë të papunë, ose kanë marrë rrugën e mërgimit, duke mos e gëzuar lirinë, për të cilën kanë luftuar. Familjet e dëshmorëve duhet të kenë mbështetje institucionale, e jo të lihen në mëshirë të fatit. Pra, një ligj për mbrojtjen e vlerave të UÇK-së është më se i domosdoshëm. Ka shumë zëra që thonë se nuk ka nevojë për një ligj të tillë, por është plotësisht e kundërta. Kosova është mirë që ta ketë sa më parë një ligj të tillë, ku vlerat mbrohen me ligj dhe askush nuk guxon t'i nëpërkëmbë.

5. Në këtë kohë, Kosova përballet me shumë sfida: me pandeminë Covid-19, krizën ekonomike, me Gjykatën Speciale, papunësinë, izolimin dhe injorimin nga BE-ja për lëvizje të lirë të qytetarëve tanë, fushatën e egër të propagandës serbe kundër shtetit të Kosovës, asociacionin etj. Shtrohet pyetja, a po bëhen

padrejtësi të vazhdueshme ndaj këtij populli dhe pse? Në radhë të parë, duhet ta kemi parasysh që Evropa nuk po largohet dot nga shablloni i padrejtësive historike që i ka bërë popullit shqiptar, sidomos në Kosovë. Ne, përjetësisht i jemi falënderues NATO-s dhe bashkësisë ndërkombëtare për ndihmën për çlirim. Por, sot, Evropa nuk duhet ta favorizojë Serbinë në rrugën e integritetit evropian dhe ta lë anash Kosovën. Diplomatat evropiane do të duhej të mendonin mirë se kush u solli luftëra dhe dhimbje gati të gjithë popujve të ish-Jugosllavisë, veçanërisht në Kosovë dhe Bosnjë. Një gjykatë speciale do të duhej të ngrihej për krimet dhe gjenocidin serb të kryer në Kosovë dhe kriminelët të marrin dënimin e merituar. Vetëm atëherë do të vihej drejtësia ndërkombëtare në vend. Tash, kohën e fundit, Lajçak paska shpikur idenë se Kushtetuta e Kosovës duhet të ndërrohet dhe të formohet një asociacion serb, që dëmton dhe cenon rëndë pavarësinë e vendit tonë. Jo, kjo gjë nuk duhet lejuar të ndodhë në asnjë rrethanë. Spektri politik i Kosovës duhet të jetë i bashkuar dhe t'i kundërshtojë ashpër tentativat e Vuçiqit dhe të Daçiqit dhe të cilitdo që provon ta denojë rendin kushtetues në Kosovë. Përfaqësuesit e popullit duhet të jenë unikë, në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës.

Kamenica, komuna e vetme në Kosovë që angazhon logopedë

KAMENICË, 29 TETOR (ER) - Komuna e Kamenicës për herë të parë ka angazhuar dy logopede që do të merren me vlerësimin dhe çrregullimet eventuale të fëmijëve në të folur dhe komunikim. Kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, është shprehur entuziast për angazhimin e këtyre logopedeve sepse, sipas tij, kjo ka rëndësi të madhe për zhvillimin e fëmijëve. "Kamenica, komuna e parë në Kosovë që angazhon logopedë. Tejet i lumtur që fëmijëve të Kamenicës po u sjellim specialistë nga të gjitha fushat, sidomos pedagogët, psikologët e, së fundmi, edhe logopedët.

Shpeshherë fëmijët kanë çrregullime të gjuhës, të të folurit, komunikimit dhe zërit, por për këtë duhet paguar seanca të veçanta. Ne si qeverisje po u mundësojmë që këto shërbime të merren falas në çerdhe dhe shkolla. Bashkëpunimi mes logopedëve, edukatoreve, mësimeve dhe prindërve, ka tejet rëndësi në vlerësimin e zhvillimin gjuhësor të fëmijët dhe shkaqet se çka ndikon në ndalimin e zhvillimit. Më pak fjalë e shumë punë, po ofrojmë kushte më të mira për të gjithë!", ka thënë Kastrati. Ndërsa drejtoresha e Drejtorisë



Komunale të Arsimit, Mirhane Morina-Bislimi, ka thënë se ndihet e lumtur për mundësitë që janë duke ua ofruar fëmijëve për zhvillimin e tyre.

"Në funksion të kryerjes së detyrave tona dhe ofrimit për fëmijët gjithë atë që kemi mundësi të ofrojmë, kemi angazhuar logopedet,

asistentet për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore dhe mësimdhënës mbështetës. Tashmë trajtohen të gjitha rastet e veçanta dhe nuk kanë nevojë prindërit vetë të paguajnë për shërbime që ne kemi marrë përsipër të ofrojmë. Mbështetja e tillë për prindërit dhe fëmijët rrallë diku ofrohet nga institucionet publike dhe jemi shumë të lumtur që ne e kemi këtë përgjegjësi dhe e kryejmë këtë detyrë", ka thënë Morina-Bislimi.

Angazhimi i logopedëve do të shtrihet në të gjitha shkollat e Komunës së Kamenicës, varësisht ku do të ketë nevojë.



'Këngëtorja arbëreshe' e Santorit përballë 'Këngës së këngëve' dhe "Canzoniere" të Petrarkës

Nga Anton Nikë BERISHA

Vepra e shkrimtarit arbëresh, Françesk Anton Santorit (1819), *Il canzoniere albanese & Këngëtorja arbëreshe*, jo vetëm është ndër më të rëndësishmet të hartuara nga ai, po njëherit të ballafaqon me dukuri të natyrës teorike, të tekstit të veçantë poetik dhe të shtjellimit të tij dhe është e hapur për qasje e interpretime nga më të ndryshmet. Gjithë kjo përligjet nga mënyra e thënies dhe e gërshetimit të formave shprehëse të tekstit, të vargjeve metrikisht të ndryshme dhe e mesazheve poetike.

Për hartimin e kësaj vepre të qenësishme poetike Santori pati parasysh tradita të ndryshme letrare dhe një varg veprash të shkrimtarëve të shquar, arbëreshë e të huaj, por duhet përmendur sidomos katër burime kryesore:

- 1) *Poezinë gojore arbëreshe*,
- 2) *"Këngët e Milosaut"* (1836) të Jeronim De Radës,
- 3) *"Canzoniere"* (Këngëtoren) të Françesko Petrarkës dhe
- 4) *"Këngën e këngëve"* të Besëlidhjes së Vjetër.

Pra, Santori shfrytëzoi përvojën e shkrimtarëve të mëdhenj e të shumtë para tij, përkatësisht vepra e tyre. Ai nuk u

bë kopjues dhe imitues i tyre, po ato ishin nxitje, ishin vetëm pasurim i përvojës dhe i dijes së tij për artin e fjalës e për punën e hartimit të veprave letrare. Në krijesat e veta poetike Santori dëshmoi mëvetësinë si krijues; zbatoi mënyrën e vet në përfitim të tekstit – të strukturës gjuhësore poetike, konceptimin dhe shtjellimin e mëvetësishëm. Tek Santori ndodhi ajo që thotë Borhes, kur bën fjalë për ndikimin e shkrimtarëve në shkrimtarët e tjerë: "Sa janë ndikimet që mund të dallohen në këtë vëllim [...] Në vend të parë shkrimtarët që pëlqej, kam veçuar tashmë Robert Browning; pastaj ata që kam i lexuar dhe rilexuar; pastaj ata që nuk i kam lexuar kurrë, por që janë brenda meje".

Në të vërtetë, në "Këngëtoren arbëreshe" përligjet ajo që thoshte T. S. Eliot: "Asnjë poet, asnjë artist i cilitdo art, vetëm nuk e ka kuptimin e plotë. Rëndësia e tij, të çmuarit e tij, është të çmuarit e marrëdhënies së tij me poetët dhe artistët e vdekur" dhe "Me kënaqësi flasim për hollësitë e ndryshimit të poetit nga paraardhësit e tij, veçmas nga ata menjëherë para tij; orvatemi të gjejmë diçka që mund të izolohet me qëllim që të kënaqemi me të. Ndërkaq, nëse i qasemi një poeti pa këtë paragjykim shpesh do të vërejmë se jo vetëm pjesët më të mira të veprës së tij, por edhe ato më individuale mund të jenë mu ato me të cilat poetët e

vdekur, stërgjyshërit e tij, e kanë siguruar pavdekshmërinë e tyre në mënyrën më të fuqishme. Dhe nuk e kam fjalën për periudhën impresioniste të rinisë, por për atë të pjekurisë së plotë".

Këtë përcaktim Santori e thekson në fillim të veprës "Këngëtorja arbëreshe": dashurinë që e vështron në të nuk e përjetoi vetë, po lexoi dhe e mësoi nga librat:

*Për dírë, për namurí shumë vjershe shkruajta,
Moj ndë ktë zemër namurí së ndieta:
Ndë gjëllë sa mbeta ndonjë kopile së rùata,
e vetëm at[ë çë] dhjovasa aní rrefyeta.
(Për eph, për dashuri shumë vjersha shkrova,*

*por në këtë zemër dashuri nuk ndjeva:
sa qeshë në jetë një vajzë s'e shikova
vetëm atë që lexova këtu e rrëfej).*

Nëpërmjet tekstit të kësaj vepre Santori thekson dhe një dukuri të rëndësishme, qoftë për vetë aktin e krijimit në përgjithësi, qoftë për aktin e krijimit veprën së tij – "Këngëtorja arbëreshe": vepra letrare në veçanti, përkatësisht teksti letrar nuk mund të shkruhet në çdo kohë dhe në çdo rrethanë; për hartimin e krijesës me vlera të mëdha poetike është i nevojshëm frymëzimi, përkatësisht fuqia shpirtërore, përqendrimi dhe përkushtimi i mirëfilltë. Krijimi i artit nuk

është një veprim i rëndomtë; janë një varg përbërësish, herë – herë të pashpjegueshëm edhe nga vetë autori, që e kushtëzojnë lindjen e veprës poetike. Në këtë rrjedhë, sipas Santorit, rëndësi të veçantë ka hareja e krijimit. Këtu qëndron arsyeja e asaj që ai thotë në fund të "Kangjelit të valles" (që vjen pas Vjershit IV): gjatë hartimit të kësaj vepre, në një çast, ndihej "i lodhur", prandaj hartimin e saj do të vazhdonte një ditë tjetër, kur do ta ndjejë nevojën shpirtërore krijuese, përkatësisht harenë e krijimit: Po u lodha; e zëmë papá / Njetër ditë çë të kem gharé. Sipas përcaktimit të këtillë vepra letrare artistike është fryt i përsiatjeve dhe i konceptimeve, i mëdyshjeve dhe i ballafaqimit, që (pastaj) marrin formë në tekstin përkatës, në veprën artistike përkatëse. Me fjalë të tjera, "Këngëtorja arbëreshe" e Santorit është krijesë e mendjes, e përvojës së tij (po ashtu e mësuar dhe nga librat), që, si e tillë, e shprehur përmes tekstit, mesazheve poetike, bëhet përsëri përvojë e njerëzve. Në "Këngëtoren arbëreshe" dashuria vështrohet në mënyrë sa konkrete, aq simbolike e përfytyruese. Kjo mënyrë krijuese zbatohet pikërisht në vështrimin e dashurisë – si dukuri e qenësishme të jetës së njeriut, duke e ndërlidhi para së gjithash me lumturinë dhe me bukurinë. Thuhet me të drejtë se pikësynimi kryesor i botës dhe i shpirtit të njeriut është

bukuria (e njësuar me lumturinë); ajo është nxitëse dhe ngushëlluese e veprimt dhe ngërthen në vete fshehtësi të jashtëzakonshme; vetë Hyji është triniteti i dashurisë dhe ekziston si plotni dhe marrëdhënie e dashurisë midis njerëzve. Pra, synimi i Santorit ishte që të përfutonte një vepër letrare sa më cilësore, një himn, një mozaik poetik që do t'i përjetësonte qenësinë e dashurisë, të bukurisë dhe të lumturisë. Ai u mbështet në parimin e njohur me të cilin De Rada e hartoi veprën e vet "Këngët e Milosaut": "[...] rendi artistik dhe harmonia e së tërës duhet kërkuar për secilin kuadër, mbasi në ta, patjetër, gjendet ngjasimi e fisnikëria e fabulës, e vërteta dhe idealiteti shërues i karaktereve dhe shqisa simbolike e sendeve".

Santori e vështroi dashurinë nga fakti se ajo është më e fortë se vdekja; asgjë nuk shpreh më thellë dhe nuk lidhet më shumë me shpirtin e njeriut sa ajo: "Veç dashurisë asgjë s'të hyn në sy!" (Petrarka, CCV) dhe se "nuk e njeh turpin" (sipas Isakut nga Niniva).



"Këngëtorja arbëreshe" nuk është një poemë e mirëfilltë klasike, ku pjesët afrohen e njësohen në tërësi. Për këtë dëshmon edhe fakti se Santori e shkroi atë në kohë të ndryshme. Sipas datave të botimit original të veprës, dy strofat e fillimit (ku tregohet objekti që trajtohet), ai i shkroi më 1845 (f. 4 – 5); "Odhí e I" më 1837 (f. 6- 11), "Këntëk e IV" (lexo: Kënga IV) më 1839 (f. 52), ndërsa "Vjershi XIII" më 1840 (f. 56). Mirëpo, edhe po të mos ishin këto data të ndryshme, pas leximit të vëmendshëm nuk është vështirë të vërehet se "Këngëtorja arbëreshe" është një tufë vjershash, që i njësion objekti artistik i trajtuar dhe sistemi shprehës

poetik. Pra, duke e njësuar qenësinë e dashurisë, të bukurisë dhe të lumturisë në strukturën gjuhësore, Santori krijoi një realitet artistik sa të pasur aq të veçantë. Trembëdhjetë pjesët me titull "Vjershi" (secila pjesë ka 8 vargje njëmbëdhjetërokëshe, gjithsej 104 vargje) janë imazhe të ndryshme të dashurisë të konceptuara dhe të shtjelluara sipas një modeli të caktuar. Katër "këntëkët" (katër këngët me gjithsej 150 vargje) janë shtjelluar kryesisht me vargje tetërokëshe të ndara në strofat katërshe e gjashtëshe.

Edhe gjuha dhe vargjet me të cilët janë krijuar "Odhí e I", "Kangjel i valles", "Të përpjekurit", edhe pse nuk janë ndërtuar përherë me të njëjtin masë metrike, afrohen më shumë me stilin, me sistemin e të shprehurit të këntëkëve, po dhe e pjesëve të tjera.

Duke pasur parasysh mënyrën e perceptimit dhe të shtjellimit të tekstit, tablotë poetike dhe mesazhin shumëor që del prej strukturës së vargjeve masash të ndryshme metrike, mund të thuhet se vepra "Këngëtorja arbëreshe" e Santorit është fryt poetik i mendjes (Dekarti thoshte: Cogito, ergo sum – mendoj, pra jam) dhe i dijes së tij, për shumëçka e veçantë dhe e rëndësishme për letërsinë tonë.

Burim të rëndësishëm për hartimin e "Këngëtores arbëreshe" Santori pati dhe veprën e Françesko Petrarkës "Rerum vulgarium fragmenta" & Fragmente të shkruara në gjuhën popullore e njohur si "Canzoniere" (Këngëtorja), nga e cila shfrytëzoi titullin, tematikën e dashurisë dhe pjesërisht çështje të shtjellimit. Këtë ndikim vepra e Petrarkës e bëri dhe në



shumë breza poetësh botërorë, duke u bërë kështu "përmbledhja lirike më e imituar në gjuhën italiane".

"Këngëtorja" e Petrarkës nuk është poemë tërësore, por një përmbledhje e lirikave të dashurisë, ku këndohen dhe për çështje të moralit e të fesë. Edhe pse në të, siç thekson Alberto Chiari (Kiari), ngjarja nuk zhvillohet sipas një vijimësie të mirëfilltë e të qartë, nga struktura e soneteve dhe e poezive formash të tjera – të gjitha të krijuara me vargje metrike, rrezaton një shumësi mendimesh, ku ndërliiden dashuria trupore, shpirtërore dhe hyjnore. E Dashura e Poetit, Laura, është vajzë që ka shkaktuar shqetësim dhe tronditje në shpirtin e tij: Ju që dëgjoni vargjeshe zërin tim, Ato psherëtima q'ushqyen zemrën time (I)

E imja shpresë e tretur po lëngonte
Si një qiri që dridhet, flakërin,
Si ëndërr e fikur që sillte veç trishtim.
(XXXIII)

Vajza e bukur është frymëzimi, liria dhe robëria e Poetit, gëzimi dhe fatkeqësia, shpresa dhe dyshimi i tij:

Dhe vargje shkruaj për ty shumë' e më shumë
dhe dor' e penë, e frym', e mend
përpjekje bëjnë të japin shpirtin tënd.
(XX)

Petrarka e percepton dhe e shqipton dashurinë në një degëzim të gjerë kuptimi; ajo është sa e domosdoshme e ngushëlluese, po aq shkaktonte dhembje dhe vuajtje, të cilat bashkëjetojnë brenda saj.

Me tjetër varg po qaj me pikëllim
Të shuhet shpresa, dhimbje e kotësi
Që i njeh mirë, kush ra në dashuri,
Të falur s'dua, po vetëm përdëllim. (I)
Shkak i gjithë asaj që ndodh në veprën e Petrarkës është bukuria e jashtëzakonshme e Laurës; janë sytë e saj sa vrashtar, aq dhe të ëmbël që ë bëjnë natën ditë e ditën errësirë dhe nga helmi e thithin ëmbëlsirën:

O sy të bukur që vrisni dhe pastaj
S'e mbyllni plagën, e lini të kullojë,
S'ka mirësi, as bar që ta shërojë,
As det me valë të thotë: po u ndaj! (LXXV)

E syt' e saj të bëjnë vetë çudinë:
Ta bëjnë drit' natën e ditën errësirë.
Dhe në farmak të thithësh ëmbëlsirë.
(CCXV)

Duke kënduar dashurinë, poeti Petrarka e grish Laurën t'i përgjigjet dashurisë së tij në të njëjtën mënyrë (siç ndodh, fjala vjen, në Këntëk e II të "Këngëtores arbëreshe": Po me gjithë se [më] jep ti mua / Këto vllpe, s'u harrua / Nga ti shpirti e të luton), po ka pak shpresë se kjo do të ndodhë. Vajza dëshmohe shpesh zemërashpër, gjë që e bën atë të ndjehet i pafat dhe i mjerë. Megjithatë, Poeti e ndjen thellësisht dashurinë për Laurën, e cila është bërë pjesë e mendimeve të tij dhe e drejton kah Qielli, me ç'rast dashuria merr përmasë hyjnore. Pra, ai jeton vetëm për të përfutuar e kënduar poezi në shenjë të lavdërimit të bukurisë së të dashurës.

Një pjesë e madhe e soneteve dhe e lirikave të "Këngëtores" së Petrarkës shqiptojnë zërin dëshpërues për vdekjen e Laurës. Mirëpo, siç theksojnë njohësit e kësaj vepre, shenja e përhershme e qartë


e kësaj krijese poetike të Petrarckës, është edhe dashuria për poezinë, që i mundëson Petrarckës të tejkalojë realitetin konkret.

4) Një burimi tjetër, mbase më i rëndësishmi, ku u mbështet Santori për hartimin e “Këngëtores arbëreshe”, është “Kënga e këngëve” e Besëlidhjes së Vjetër. Kjo krijese poetike është nga më të veçantat e më të ndërlidhshmet që njeh arti letrar i mbarë njerëzimit. Vështirë është të gjendet edhe një vepër tjetër poetike që ka zgjuar qasje e interpretime kaq të shumta e të ndryshme, qoftë për ta përligjur përfshirjen e saj në Shkrimin e Shenjtë, Biblën, pra si vepër e përshtirshme, qoftë si kryevepër e artit të fjalës.

Njohësi dhe studiuesi i shquar i saj, A. Chouraqui, vë në dukje se “Vepra (Kënga e këngëve – v. ime) nuk duhet të futet në rrafshin e një rrëfimi, e një drame, as të një krijese letrare apo poetike të zakonshme. Ajo, para së gjithash, është e ndjeshme ndaj ndryshimeve të së qenmes (ekzistencës), aq më tepër ndaj përparimeve të saj; frymton një shndërrim (metamorfozë) kaq absolute të dashurisë që mund të vendoset në fillesën (pragun) e një shëlbimi, të një shpëtimi. Për këtë (arsye) ajo shtron një domosdoshmëri: t’i mbesë krejtësisht besnike absolute të dashurisë dhe, në këtë kontemplim marrëzor, të shkohet deri në fund në një marrëzi që përmbushet në shekull”.

“Këngën e këngëve” e bën të këtyllë gjuha sa e veçantë dhe e pasur si dhe mënyra e shtjellimit të pjesëve poetike dhe të tekstit në tërësi; një tekst i gjallë, që shpaloset në rrafshin e në format më të shumëllojshme jo vetëm për breza të kohëve të ndryshme, po edhe për të njëjtin lexues ose receptues, interpretues të saj: “Edhe përballë kuptimeve të saj përkthyesi, komentuesi ndjehet i paaftë. Është një tekst i gjallë; të kufizosh (tekstin) nëpërmjet shënimeve dhe referimeve a nuk do të thotë ta vrasësh? Fjalët në të janë si zogj të zjarrtë. A është e mundur t’i vësh në kafaz? Çdo shpjegim i mundshëm rrezikon të përjashtojë një përthellësi më të sakët, më të vërtetë, më të madhe nga ajo që është parathënë. Çfarëdo vendimi që të merret, dashuria, që për natyrën e saj është liri, burgoset në një rrjet të koncepteve të pamjaftueshme (të kufizuara), si prapa shpatëzave të një kafazi”.

Në qenësinë e saj “Kënga e këngëve” është një përzgjedhje e këngëve të martesës, përkatësisht “himi i martesës” në gjuhën hebraike me elemente të



ndjeshme të aramishtes e me ndikim të persishtes, që trajton dashurinë fizike, shpirtërore dhe hyjnore, të njësuara midis tyre dhe shprehin jetën e njeriut dhe kuptimin e saj.

E përbërë prej himneve të dashurisë me paralele në Lindjen e lashtë, “Kënga e këngëve” dëshmon vlerë të mirëfilltë poetike dhe përmasën e thellë njerëzore. Në të vërtetë, ajo i “kushtohet gëzimit të vijueshëm të jetës” dhe është ballafaqim shpirtëror e mendor i të dashuruarve, dëshmi e dashurisë së çiltër e të pastër për njëri – tjetrin, ashtu si thuhet në Ungjillin e Gjonit: “S’ka dashuri më të madhe sesa të japësh jetën për personin që e do”.

Mënyrat e ndryshme të shqiptimit të dashurisë në “Këngën e këngëve”, po dhe në “Këngëtoren arbëreshe”, dëshmojnë se “Dashuria nuk është krejtësisht një fenomen ‘privat’, një histori e thjeshtë e dy

‘zemrave’ që dashurohen, po ngërthen në vete një ‘parim të ndërlidhjes’ së çmueshme për kolektivitetin” (A. M. Kollontaj) dhe se “Çdo akt i dashurisë, i përkujdesjes, i përdëllimit është një ringjallje” (Erich Fromm).

Monologët e të dashuruarve në “Këngën e këngëve” ballafaqohen e përplotësohen midis tyre, siç ndodh dhe në “Këngëtoren arbëreshe” midis Vashës dhe Timit, veçmas në “Këntëkët” (këngët) dhe në “Të përpjekurit”. Në “Këngën e këngëve” e Dashura dhe i Dashuri janë të njësuar:

Unë jam i të Dashurit tim / i Dashuri im është i imi... (KK 6, 3). Vasha e dashuruar me bukuri të jashtëzakonshme është sa konkrete aq dhe hyjnore:

E panë vashat dhe i thanë e lumtur, mbretëreshat dhe shemrat e mbuluan me lavde:

Cila është ajo që shfaqet si agimi

e bukur si hëna, e shndritshme si dielli e mahnitshme si ushtri flamujsh shpalosur.

(KK 6, 9-10)

ose

[...] dashuria jote më e ëmbël se vera, parfumi yt që del nga ti më i mirë se çdo erësim.

Buzët e tua nektar kjasojnë, oj nuse, nën gjuhën tënde rrjedh mjaltë e qumësht.

(KK 4, 10 – 11)

Pra, Santori u mbështet në “Këngën e këngëve”, qoftë për tematikën e dashurisë, qoftë për llojshmëri imazheve poetike kushtuar dashurisë dhe martesës. Vajza e bukur në veprën e Santorit dhe vajza e bukur e “Këngës së këngëve” afrohen për disa tipare, që vërehen edhe nga një lexim i zakonshëm i teksteve të tyre. Arbëreshja ka bukurinë e yjeve, dritën e Hënës dhe ngrohtësinë e Diellit, me çka përligjet koncepti i përjetësismit poetik të së Bukurës si ideal jetësor:

O! via, prirë ballin e bårdhë

Çë shëron zemrat sëmurë.

Leshtë e arëm, çë si grurë

[i] marr nga era dridhet, ardhë

Nëng u pá nga rrasu dhé,

Ndo si jotja jetër hjé

O ndë gjëllë çë shkoi vo qe. (Odhí e I)

(O! Ma trego ballin e bardhë

që i shëron zemrat e sëmurat.

Flokët e arta sikur grurin

që e tund era asnjë grua

nuk i ka mbi dhé si ti,

as s’e patën hirin tënd

dhe në kohët e kaluara.)

Ftyrë-dritëm e gavnore

Si e ré monosare. (Këntek e II)

(Fytyrë ndritur dhe e hareshme

si një manushaqe e re.)

Bállët [t]ënd ylet gëzon,

Fton hënën të të shóhë,

Dielli vjen më ndën të njohë

Bukurinë çë të lartón. (Odhí e I)

(Balli yt vjet i gëzon

e grish hënën që ta shohë

dielli zbret që ta njohë

bukurinë që të lartëson.)

Edhe si sasi këto dy krijesa poetike,

“Kënga e këngëve” dhe “Këngëtoren

arbëreshe”, përngjajnë.

Afritë, ngjasimet dhe përkimet e

“Këngëtores arbëreshe” të Santorit dhe të

“Këngëtores” së Petrarckës dhe të “Këngës

së këngëve” të Besëlidhjes së Vjetër

dëshmojnë rëndësinë e shumëfishtë të

kësaj vepre poetike të poetit tonë

Santorit./Exlibris.al

‘Dhuna nuk fshehet mrena mureve’, ekspozita që synon ndërrimin e mentalitetit

Sot do të organizohet hapja e ekspozitës “Dhuna nuk fshehet mrena mureve” nga Rrjeti i Grave të Kosovës përpara Teatrit Kombëtar të Kosovës, duke filluar nga ora 10:00 e deri më 16:00.

Ekspozita do të sjell rrëfime reale të grave dhe burrave të cilët ishin viktimë të dhunës në familje, duke pasur synim vetëdijesimin e qytetarëve për

ndalim të këtij fenomeni negativ të shoqërisë. Në të njëjtën kohë kjo ekspozitë do të njoftoj publikun e gjerë se në rast të përbaljes me dhunë duhet të mbështeten dhe si të kërkojnë ndihmën institucionale.

Ekspozita vjen me një emërtim simbolik “Dhuna nuk fshehet mrena mureve” me qëllim të ndërrimit të mentalitetit se ajo

çfarë ndodh në një familje duhet të qëndroj përbrenda mureve të tyre. Në këtë formë synohet zëvendësimi i saj me ndihmë e mbrojtje ndaj çdo viktime, pa i lënë ato në neglizhencë.

Përgjatë kohës së pandemisë rastet e dhunës në familje janë rritur, ku në periudhën kohore mars-qershor në Kosovë janë raportuar rreth 40% më shumë

raste në Policinë e Kosovës, ndërkaq ky numër mund të jetë më i madh edhe nga ata të cilët nuk e raportuan dhunuesin.

Kjo ekspozitë që është hapur edhe në vitin 2019 në Sheshin “Skënderbe”, përkrahët nga Bashkimi Evropian (BE) përmes UN Women (Women#EVAW) dhe Agjencioni Austriak për Zhvillim (ADA). / KultPlus



Aspekti historiko-simbolik i poemës 'Qerbelaja'

Nga: Sadik BEJKO

"Qerbelaja", vepër e Naim Frashërit, botuar në Bukuresht më 1889, është një poemë epike me subjekt nga historia e Kalifatit arab. Poema shtjellon ngjarje që ndodhin në shekujt IX-XV. Ngjarjet kryesore zhvillohen në luginën e Qerbelasë, në Irak.

Treva e Qerbelasë si gjeografi shtrihet në një largësi prej 100 kilometrash në jugperëndim të Bagdadit, në kufi të shkretëtirës arabe, buzë lumit Eufrat.

Aty, në tetor të vitit 680, nipi i Profetit Muhamed, Imam Huseni u vra bashkë me 72 meshkuj luftëtarë të Familjes së Profetit, ndërsa femrat e tyre, të mbetura gjallë, u robëruan dhe u keqtrajtuara nga ushtria e Jezidit, kundërshtarit fitimtar. Një gjakderdhje e përmasave të tilla, theorizimi i kaq burrave të një familjeje, flijimi i fëmijëve dhe i grave, i bënë ngjarjet e fushës së Qerbelasë tërheqëse për poetët me frymëzim tragjik. Fusha e Qerbelasë tej e përtej e përgjakur jepte dorë për të thurur vepra epike të mburitura me frymë sublime.

Si temë e zymtë dhe e madhërishme, kjo do t'i shkante përshtat talentit të një poeti siç ishte Naim Frashëri, poet i dimensioneve tragjike dhe universale. Naimi e mori këtë ngjarje të ikonave themelore historiko-fetare të myslimanëve arabë, e mori këtë histori të largët Lindore dhe e ktheu në poemë epike që fliste shqip, fliste edhe për shqiptarët.

Për të hyrë në thelbin e ngjarjeve, le të shohim ç'thonë kronikat e lashta për motivet që çuan në tragjedinë e Qerbelasë. Historia e trazuar e Kalifatit arab merr një kthesë të papritur pas vdekjes së Profetit Muhamed më 632.

Udhëheqësit që e zëvendësuan Profetin pas vdekjes së tij, u quajtën Kalifë, domethënë mëkëmbës të Profetit, ndërsa pushteti perandorak arab i ushtruar prej tyre u quajt Kalifat. Me ardhjen si Kalif i kësaj perandorie të imam Aliut, dhëndrit të Muhamedit, Kalif që

sundoi nga viti 665 deri më 661, filloi lufta civile, përleshja me armë me Mavijen, guvernatorin e Sirisë, pinjollin nga familja e rëndësishme e Umajadëve. Nga kjo luftë për pushtet Aliu mbetet i vrarë. Mavijes, fitimtarit, i mbeti barra e stabilizimit të Perandorisë arabe. Dhe ai ia arriti.

Historia vijon me dinastinë e Umajadëve me qendër në Damask, me dinastinë e Abasidëve me qendër në Bagdad, familje që kryesuan Kalifatin arab, e shtrinë sundimin e tij deri në Spanjë dhe nën udhëheqjen e tyre, qytetërimi i veçantë arab arriti kulmet e lulëzimit të tij.

Nga ana tjetër, kjo periudhë do të shoqërohej me revoltat e kundërshtarëve të Umajadëve, të cilët ishin përqendruar në Iran, Irak etj. Këta mendonin se Kalifati i takonte Aliut dhe pasardhësve të tij si trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të Profetit. Umajadët, sipas tyre, ishin uzurpatorë. Kjo ndarje jo vetëm politike, por edhe teologjike, fetare vazhdon deri më sot.

Familja e Aliut e mëtonte trashëgiminë e Kalifatit si zgjedhje të dhënë nga ana e Zotit dhe e Profetit Muhamed. Sipas tyre, Profeti para se të ndërronte jetë, në Luginën e Gadirit takoi krerët që e pasonin dhe u la porosi që pas tij të vinte në krye Imam Aliu, i emëruar prej tij si Imam i gjithë umetit mysliman.

Meqë kjo nuk ndodhi, plasën luftërat shekullore për pushtet, luftëra për kryesimin e Kalifatit. Këtu e merr lëndën poema e Naim Frashërit.

Përtej lëvizshëm historike të luftërave civile për pushtet, realiteti i miliona viktimave të dhunës çnjerëzore, flijimi i të pafajshmëve, i të pafuqshmëve, i të pambrojturve, u dhanë ngjarjeve të Qerbelasë një përmbajtje të lartë ideologjike, përmbajtje fetare, frymëzim hyjnor të luftës mes së mirës dhe së keqes e, të luftës mes Zotit dhe djallit, pra, u gatua një lëndë e së madhërishmes, e tragjike, lëndë që ushqeu dhe ushqen ndarjet përçarëse fetare



të përmasave të tilla që vazhdojnë edhe sot.

Në këto motive të theorive të përgjakshme e ngjeu penën për të shkruar poemën e tij Naim Frashëri. "Qerbelaja" si vepër artistike formëson poetikisht këtë brumë të përzishëm tragjik me burim nga historia.

Qerbelaja, shkretëtira e mbuluar nga përgjakja e të flijuarve njerëzorë, me ndërhyrjen e poezisë, nga një lëndë e gjallë, konkrete, shndërrohet në materie artistike, kthehet në simbol të së përzishmes, në metaforë therorije, ngjashëm me vende të rrënuara, vende të kthyerat në hi, vende të shfarosura me rrënjë nga luftërat çnjerëzore, vende që historikisht e përjetësisht simbolizojnë fatkeqësi, mizori, katastrofa, si Troja, Kartagjena, Vaterloja...

Qerbelaja në poemë nuk është më toka... është idealiteti, frymorja, hyjnorja.

Vende si Troja, Kartagjena, Qerbelaja... nuk janë vetëm shenja në histori, por dhe topikë në simbolikë, në idolatri.

"Qerbelaja" e N. Frashërit nuk është vepër historike, është poemë epike himnizuese me mesazhe metafizike që nuk njohin hapësirë dhe kohë konkrete. Ajo u flet të shtypurve të çdo kohe dhe të çdo hapësire, u thotë se si duhet vepruar nën dhunën dhe nën mizoritë e tiranëve. U thotë të shtypurve se ju, duke paguar me heroizëm, me gjak dhe me sakrificë sublime për një ideal të lartë, do

të krijoni një kauzë të shenjtë që nuk do të harrohet kurrë ndër shekuj.

Pse Naim Frashëri në vitin 1889, një vit para se të vdiste, botoi "Historinë e Skënderbeut" dhe "Qerbelanë", dy poema epike, njëra me ngjarje dallueshëm kombëtare, tjetra me frymëzim fetar dhe me temë ndërkombëtare?

Për "Historinë e Skënderbeut" dihen shtysat. Ai ishte poeti misionar i popullit të vet. Ishte mësuesi, ideologu kombëtar. Figura e Skënderbeut ishte në përputhje me idealet e Rilindjes Kombëtare.

Po "Qerbelaja", përse duhej shkruar?

Studiuesit kanë dhënë shumë shpjegime, që nuk i përjashtoj. Naimi ishte i frymëzuar nga kultura persiane, ishte ndikuar nga paraardhësit e vendlindjes që shkruanin poema të gjata me tema historiko-fetare. Naimi ishte filozof i bektashizmit. Ishte panteist, ishte mistik. Po. Këto dhe të tjera shpjegime kësisoj, janë të pranueshme. Të gjitha. Veç me një ndryshim... Mbase është koha të themi edhe diçka tjetër. Poeti është poet. Si poet me talent ai i shpërthen kufijtë, del jashtë kohës dhe jashtë vendit të vet. Bëhet qytetar i botës.

Poezia, materia poetike me cilësitë e saj universale, e bëjnë poetin qytetar të botës. Jo tjetër gjë. Poeti i mirë nuk mbetet vetëm apostull në altarin e kohës së tij e të kombit të tij.

Temat ngjethëse, temat tragjike,

universale, madhështitë pa kohë e pa vend, që nga poet Bajroni edhe më përpara tij, ishin të parapëlqyera nga gjithë poetët, në veçanti nga romantikët. Ata i gjuanin gjëmat, tragjeditë botërore.

Kështu dhe Naimi ynë me "Qerbelanë".

Si poezi me lëndë tragjike ajo i përket gjithë njerëzimit, si frymëzim fetar u flet vetëm besimtarëve bektashinj.

Është një poemë që sot mund t'i flasë më afër një lexuesi që adhuron tarikatet e Islamit. Kjo ngaqë himnizon gjakun e dëshmorëve të Qerbelasë, vajton flijimin e pjesëtarëve nga Familja e Profetit.

Poema "Qerbelaja" është ndarë në 25 këngë. Në secilën këngë ka heronj që nuk veprojnë në këngët më pas. Poema shqyrton ndodhi, vuajta, sakrificat, trimëri dhe përcjell mesazhe humane dhe hyjnore.

Lënda e marrë nga historia fetare arabe shtrihet prej shekullit IX deri në shekullin XVII. Lufta fillimisht zhvillohet ndërmjet Profetit Muhamed dhe Sufjanit, pastaj mes Imam Aliut dhe Mavijes, mes Imam Husenit dhe Jezidit si dhe mes Muhtarit me Mervanin (birin e Jezidit), pra, luftëra të pandërprera mes dy fiseve që shkojnë nga një brez në tjetrin.

Poema fillon me lajmërimin e ardhjes së një feje të re me misionar Profetin Muhamed. Vazhdon me flijimin e nipit të tij Imam Husenit, me hakmarrjen e Muhtarit, stërnip i brezit të katërt, dhe përmbillet në këngën XXV me një mesazh për popullin shqiptar, për të krishterët dhe për myslimanët. Naimi do të edukojë të bashkatdhetarët ndjenjat e larta të fisnikërisë, të humanitetit, të besimit në hyjnorin.

Për lexuesin e sotëm, një poemë si "Qerbelaja", përtej mesazheve fetare, ia vlen të lexohet për shijen e tragjike, për madhështinë e flijimit njerëzor, për bukurinë e gjuhës, për rrjedhën muzikore të vargjeve, për arkitekturën mjeshërërore të strukturës së saj, për cilësitë artistike të një vepre të periudhës së pjekurisë të një poeti si Naim Frashëri. /Telegrafi

Whitney Houston disk diamanti edhe pas vdekjes

Edhe pas vdekjes, këngëtarja Whitney Houston vazhdon të bëjë histori, pasi, për herë të tretë, një nga albumet e saj merr një disk diamanti. Këtë herë bëhet fjalë për diskun "Whitney". Kujtojmë se statusi i një disku diamanti barazohet në


miliona e albumeve të shitura.

I njëjti status u mor nga Whitney Houston në vitin 1985 dhe me albumin "Bodyguard".

Kjo është hera e parë që një artiste afro-amerikane arrin një rekord të tillë.

Houston, e cila vdiq tragjikisht në 2012 në moshën 48-vjeçare, ka kaluar gjithashtu një tjetër rekord historik: mbi një miliard shikime në YouTube për këngën "I Will Always Love You" të vitit 1992. /atsh/





**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Përurohët fusha e tenisit në Ferizaj



FERIZAJ, 29 TETOR - Komuna e Ferizajt bëhet me fusha të tenisit. Ato janë mundësuar me investimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projekt infrastrukturor fizik u përrua sot dhe në të u investuan rreth 100 mijë euro. Në ceremoninë e përrimit të terreneve të tenisit mori pjesë ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e shoqëruar me zëvendësministrat Halil Matoshi

dhe Qazim Rrahmani, bashkë me kryetarin e Komunës së Ferizajt, Agim Aliu dhe kryetarin e Federatës së Tenisit të Kosovës, Mejd Rexhepi. Me këtë rast, ministrja ka thënë se ky investim është i rëndësishëm për tenistët e tenisit të Ferizajt dhe në përgjithësi të Kosovës ngaqë tashmë ky sport është i ndërkombëtarizuar dhe se në Kosovë po zhvillohen edhe gara ndërkombëtare, siç ishte rasti i

garave evropiane që janë mbajtur javën e kaluar në Pejë, në tenis. "Shumë të lumtur që sot njëkohësisht përruam kompleksin e fushave të tenisit, investim kapital i MKRS-së, respektivisht i Qeverisë së Kosovës me rreth 100 mijë euro. Kemi tenistë të talentuar dhe me këtë investim të ministrisë u kemi krijuar hapësirë këtyre sportistëve që ta kultivojnë talentin e tyre", u shpreh ministrja.

Riaktivizohët KH Istogu



ISTOG, 29 TETOR - Qyteti i Istogut ka vite që e ka njëren prej skuadrave më të mira të hendbollisteve në Kosovë, por tani është bërë një hap tjetër i rëndësishëm që Istogu të bëhet qendër me peshë për hendbollin në vendin tonë. Pas dy vjetësh është riaktivizuar KH Istogu, që do të garojë në Ligën e Parë të Kosovës (meshkujt). Pasi do të hapet palestra e re në Istog, kushtet për funksionim të klubit do të

jenë shumë më të favorshme. Puna në skuadrën e Istogut ka nisur tashmë, ndërsa trajner është profesori Malush Kabashi. Klubi Istogu është vazhdimësi e klubit KH Rakoshi, që ishte themeluar në fillim të vitit 2000 nga entuziasti i hendbollit dhe zyrtari sportiv, profesor Bedri Hajzeraj. Më vonë ky klub u emërua KH Istogu dhe u paraqit në garat e Ligës së Parë të Kosovës. Për shkak të vështirësive,

kryesisht mungesës së palestrës, klubi ndërpreu aktivitetin për një kohë, e që është riaktivizuar sërish. Është ky një lajm i mirë për gjithë komunitetin e hendbollit në vend. FHK-ja po punon për të riaktivizuar klube që, për shkak të vështirësive, kanë ndërprerë aktivitetin, por edhe për të hapur klube të reja. Ndihma e komunave dhe komuniteteve lokale të hendbollit duhet të jetë më e madhe.

SHKURT

Lazio dhe Torino në garë për Mirlind Dakun

Edhe një futbollist nga Kosova mund të transferohët në Itali. Bëhet fjalë për sulmuesin e Ballkanit, Mirlind Daku, i cili është më i miri në kampionatin elitër të Kosovës, duke qenë autor i 15 golave në vetëm nëntë xhiro. "Calciomercato.com" shkruan se dy klubet e Serisë A, Lazio dhe Torino, janë të interesuara për sulmuesin që është në pronësi të Osijekut. Pas formës së mirë të Dakut, nga analistët është propozuar që sulmuesi të ftohet nga përzgjedhësi i Përfaqësues A të Kosovës, Bernard Challandes.

Milani e dëshiron Mustafin

AC Milan në afatin kalimtar të dimrit do të tentojë ta bëjë transferimin e mbrojtësit shqiptar të Arsenalit, Shkodran Mustafi. Lajmi është bërë me dije të enjten nga "todofichajes.net". Mustafi ka refuzuar rinovimin e kontratës me skuadrën e Arsenalit dhe largimi i tij pritet të ndodhë në janar, pasi në verë do të largohët me parametra zero. Skuadra angleze kërkon 6 milionë euro për futbollistin shqiptar, shumë e lehtë për t'u përballuar nga Milani.

CR7 ka dalë 18 herë pozitiv me koronavirus

Cristiano Ronaldo ka qenë i dëshpëruar që nuk ka mundur ta ndihmojë Juventusin në ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Barcelonës, të cilën "Zonja e Vjetër" e humbi 2:0 në Torino të mërkurën. Portugezi doli pozitiv edhe në testin e fundit që bëri 24 orë para ndeshjes ndaj Barçës. Sipas mediumit "TV1" në Portugali, Ronaldo ka rezultuar pozitiv 18 herë. Hera e parë kur 35-vjeçari doli pozitiv ishte më 13 tetor, në kohën sa ishte i grumbulluar me Portugalinë për ndeshjet e muajit tetor të Ligës së Kombeve. Ronaldo është golashënuesi më i mirë në histori të Ligës së Kampionëve me 130 gola të shënuar.

Rikthehet futblli në Shqipëri

Një lajm i mirë vjen për elitën e futbollit shqiptar që do të rikthehet brenda pak ditësh. Në mbledhjen e organizuar gjatë ditës së sotme nga ana e Ligës Profesioniste pati edhe një shtyrje, pasi fillimisht u programua për t'u zhvilluar të premtën. "Supersport" ka raportuar se është vendosur për fundin e bojkotit. Pra të gjitha ekipet do të kthehen në fushën e lojës. Sa i përket datës së saktë, bëhet fjalë për mesjavën e ardhshme, më 4 nëntor, atje ku do të zhvillohet java e parë e kampionatit.

Liga e Parë fillon me sfida interesante

PRISHTINË, 29 TETOR - Të premten dhe të dielën do të zhvillohet java e parë në Ligën e Parë, që do të jetë mjaft interesante. Në këtë edicion, Liga do të numërojë

dhjetë skuadra që do të luftojnë për të hyrë në elitën e basketbollit të Kosovës. Të premten do të zhvillohet ndeshje interesante në mes të AS Prishtinës, që luajti në

“play-out” me Trepçën dhe RC Cola Drita, që synon të rikthehet në elitë. Po ashtu, të premten përballen edhe New Basket-Marigona Hill Prishtina dhe Lipjani-

Megasports. Ndërkohë, të dielën do të përballen Istogu me Feronikelin, ku kjo e fundit edicionin e kaluar kishte garuar në Superligë dhe Vushtrria-Prishtina e Re.



Bardhi: Jam shqiptar dhe këtë nuk ma mohon askush

Tiranë, 29 tetor - Mesfushori shqiptar Enis Bardhi ka folur në lidhje me përjetimet dhe reagimet pas fitores së Maqedonisë së Veriut ndaj Kosovës, në kuadër të gjysmëfinale së ‘play-off-it në Ligën e Kombeve. Përfaqësuesja ku aktivizohet 25-vjeçari fitoi ndaj “dardanëve” dhe tash është një fitore larg (ndaj Gjeorgjisë) për t’u kualifikuar në Kampionatin Evropian. “Jemi shumë të kënaqur që e kaluam me sukses ndeshjen me Kosovën, por nuk ka përfunduar asgjë. Kemi edhe një 90-minutësh për kualifikimin”, ka thënë Bardhi në emisionin “Sport Time” të “SuperSport”. “Edhe para ndeshjes me Kosovën kam thënë që ekipi ynë ka më shumë përvojë. Kosova ka shumë lojtarë të fortë në aspektin individual. U futëm në fushë për ta fituar ndeshjen, jo për të bërë disa gjëra në mënyrë individuale”, ka shtuar Bardhi. Futbollisti Bardhi është i bindur se Kosova shumë shpejt do të kualifikohet në Evropian. “Edhe Kosova zhvilloi një ndeshje të fortë. Më vjen keq për djemtë, por kam besim se shumë shpejt do të shkojë në Evropian. Përballja me Kosovën ishte e veçantë. Pas ndeshjes kam pasur komente



pozitive dhe negative. Çdo futbollist duhet ta japë maksimumin për ekipin ku luan. Jam shqiptar e nuk ma mohon askush, por tani do ta jap maksimumin për Maqedoninë për përparimin edhe në aspektin

profesional. Nuk kemi pasur kurrë probleme brenda skuadrës, kemi respekt për njëri-tjetrin dhe në fushë japim maksimumin. Si ekip mund të bëjmë një histori që nuk e ka bërë askush”, ka deklaruar Bardhi.

Për të ardhmen vendosi pasi ta fitoj titullin kampion

Londër, 29 tetor - Në prag të garës së radhës, që zhvillohet këtë fundjavë në Imola (Itali), piloti britanik Lewis Hamilton ka folur për të ardhmen e tij. Gjashtë herë kampioni i botës në Formula 1 pritet ta rinovojë kontratën me Mercedesin, por palët nuk po gjejnë një marrëveshje në lidhje me rrogën e pilotit. “Dua të vazhdoj të garoj. Kjo është e sigurt. Gjithsesi, nuk e di se për sa kohë do të vazhdoj të pilotoj. Nuk do të qëndroj këtu edhe për shumë vite, ndaj kjo



është një periudhë ku po e përgatis me shumë kujdes të ardhmen time”, ka thënë Hamiltoni, që kërkon rreth 40 milionë dollarë në sezon. “Unë synoj të jem sërish këtu te

Mercedesi edhe vitin tjetër, nëse planet tona do të përputhen në të njëjtin drejtim. Gjithnjë e kam thënë që palët duhet të kenë ide të njëjta për të ecur përpara, siç ka ndodhur në gjithë këto vite triumfuese për ne”, ka shtuar Hamiltoni. “Gjithsesi, për të ardhmen do të diskutojmë me Mercedesin pasi ta fitoj titullin kampion dhe më pas do të vendosim së bashku”, ka bërë me dije Hamiltoni, që kryeson renditjen e sezonit 2020 të Formulës 1.

SHKURT

Koeman: Ishte ndeshja më e mirë deri tash

Barcelona e mposhti Juventusin (2-0) në Ligën e Kampionëve. Trajneri Ronald Koeman ka thënë se kjo ishte paraqitja më e mirë e skuadrës së tij në këtë sezon. “Mendoj se ne kemi qenë superiorë, veçanërisht me lojën tonë. Kemi pasur mundësi për të shënuar edhe më shumë gola. Ishte një triumf i shkëlqyeshëm. Unë jam shumë i lumtur. Ishte ndeshja jonë më e kompletuar deri më tani. Nuk është mirë të veçosh një lojtar. Ekipi ka treguar shumë besim dhe shumë personalitet ndaj një ekipi të fortë nga Evropa. E gjithë skuadra që është veçuar në këtë lojë”, ka thënë Koeman.

Pirlo: Nuk jemi në nivelin e Barcelonës

Andrea Pirlo pësoi humbjen e parë në stolin e Juventusit. Kampionët e Italisë u thyen 0-2 në sfidën e Ligës së Kampionëve nga Leo Messi me shokë. Trajneri i ekipit italian analizoi ndeshjen me Barcelonën dhe u ndal te mesfusha, aktualisht reparti më i dobët i “Zonjës”. “E dinim që na priste një ndeshje e vështirë. Ata janë më përpara se ne me përgatitjet. Barcelona ka lojtarë për këto lloj sfidash, ndërsa ne jemi një ekip në ndërtim e sipër. Kjo humbje do të na shërbejë për t’u rritur. Shpresoj t’i kem sa më shpejt në dispozicion lojtarët që munguan. Për momentin jemi me pikatore dhe nuk kam shumë alternativa”, ka thënë Pirlo. “Mesfusha? Futbollit është me cikle dhe kemi lojtarë të rinj në këtë repart. Ata kanë nevojë për ndeshje për të krijuar përvojë. Duhet të punojmë dhe të përmirësohemi, vetëm kështu mund të përballemi si të barabartë me ekipe si Barcelona. Duhet të rregullojmë shumë gjëra në këtë repart”, ka shtuar Pirlo.

Vieri: Kur Messi largohet nga futbolli do ta hedh TV-në

Ish-sulmuesi italian Bobo Vieri shquhet për komentet e tij pikante. Një të tillë e ka bërë edhe pas ndeshjes Juventus - Barcelona, ku katalanasit triumfuan me rezultatin 0-2. Në një prononcim për “CBS Sports”, Vieri u shpreh: “Barcelona ishte mahnitëse. Nuk e di sesi ata arritën të humbnin kundër Realit. Juventus kishte mundësi t’i shënonte gjashtë apo shtatë gola me lehtësi. Luajti për mrekulli. Messi është magjistar. Ai është Herri Poteri i futbollit. Kur ai të ndalet së luajti unë do ta hedh TV-në. Nuk do të punoj në TV më. Do të shikoj Netflix, sepse kur ai të mos luajë më, nuk kam çfarë të shikoj tjetër”, ka thënë Vieri.

Pato arrin marrëveshje me Genoan

Aleksandër Pato do të rikthehet në futbollin italian për të nisur një përvojë të re. Sulmuesi brazilian ka mbetur pa ekip, sepse klubi ku bënte pjesë sezonin e fundit, Sao Paolo, vendosi të mos i rinovojë kontratën, ndonëse 31-vjeçari shënoi 5 gola në 20 ndeshjet e luajtura. Ndërkohë së fundmi media spanjolle “Don Balon” raporton se agjentët e sulmuesit kanë arritur marrëveshjen me Genoan për të nënshkruar deri në fund të sezonit, ndërsa këtë javë pritet që Pato të mbërrijë në Itali dhe t’i kryejë vizitat mjekësore.

Ndeshjet pa tifozë në Bundesliga

Gjermania kthehet pas dhe mbyll dyert e stadioneve për tifozët e ndeshjeve të Bundesligës. Agjencia kryesore gjermane e shtypit DPA raportoi se si pjesë e një plani të përgjithshëm të masave kufizuese kundër infeksionit me koronavirus, duke

filluar nga nëntori, ndeshjet e Bundesligës do të zhvillohen pa praninë e publikut. Ky është një vendim i përfshirë në mbylljen e përgjithshme të projekteve nga kancelarja gjermane Angela Merkel për ta qetësuar situatën nga pandemia deri në periudhën

e Krishtlindjes. Deri më tani liga gjermane e futbollit kishte marrë miratimin për tifozë deri në 20 % të kapacitetit të stadioneve, por jo të gjitha klubet e kishin aplikuar. Skuadra më e titulluar dhe ajo me më tepër tifozë, Bayern Munchen, nuk e kishte

rihapur Allianz Arenën për tifozët. Kancelarja gjermane Angela Merkel ka urdhëruar që nga e hëna e 2 nëntorit të gjitha ngjarjet sportive profesionale, futbollit në radhë të parë, do të kthehen të zhvillohen me dyer të mbyllura, pra pa praninë e

spektatorëve. Njoftimi vjen pasi kurba e infektimit nga Covid-19 në Gjermani vazhdon të rritet. Vetëm të mërkurën ka pasur 14 964 raste të reja. Kjo i detyron autoritetet të marrin masa, përfshirë këtë në lidhje me sportin.



Kompania Rajonale e Ujësjesit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

30.10.2020

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURIT

K.R.U-GJakova Sh.a anulon konkursin e shpallur në gazetën Epoka e Re- Portalonline-rubrika shpallje fq.15 për pozitën: Specialist/e në NJ. E Buxhetit dhe Planifikimit Financiar i publikuar me datë 14.10.2020. Konkursi është anuluar duke u bazuar në Nenin 6 pika 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.

Dep. Burimet Njerëzore

KRU-GJAKOVA- SH.A



Kompania Rajonale e Ujësjesit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

Kompania Rajonale e Ujësjesit Gjakova, Sh.A, duke u bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), nenin 4 paragrafi 1,2,3,4,5 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/ 2017 për Rregullimin e Procedurave të konkursit në Sektorin Publik shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës- Portoarkatar/e- NJO- Rahovec

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: Në kohë të caktuar/ Puna Provuase gjatë (6) muaj në pajtim me Ligjin e Punës/ Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës :

- Kryen arkëtimin në para të gatshme në llogari të Kompanisë nga konsumatorët
- Asistimi në procesin e faturimit dhe inkasimit
- Bënë arkëtimin e mjeteve nga punëtorët inkasant
- Ben dorëzimin e përditshëm të mjeteve të arketuara te Udh. e Nj. ne arken kryesore
- Ben komunikimin me konsumator sa më transparente, të qartë dhe efikas
- Si dhe detyrat tjera të cilat (mëtuje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkëpunimit të punës ose të caktuara nga punëdhënësi.

Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe karakteristikat personale.

- Përgatitja profesionale/Shkolllore- Shkolla e Mesme
- Preferohet provoja e punës 1 vjeçare që ndërlihet me pozitën apo të ngjashme.
- Aftësi për të përbushur objektivat sipas dinamikës së planifikuar.
- Aftësi të mira komunikimi dhe të bashkëpunimit.
- Preferohet njohja e punës me kompjuter (Microsoft office).
- Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Informata të përgjithshme :

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Informata të përgjithshme :

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët që plotësojnë kriteret arsimore dhe profesionale sipas konkursit.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Procedura për aplikim- Aplikacioni (formulari) për konkurrim merret në Kompani dhe në ueb-faqen e Kompanisë, dhe të njëjtës i bashkëngjiten: 1. kopja e letërnjoftimit 2. Certifikata e lindjes, 3.CV-ja 4. Letër Motivuese/ kërkesë për punësim 5. kopjet e dokumentacionit të kualifikimit(kopja e noterizuar), si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit. Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkojnë me rastin e intervistimit.

Afati i konkurimit është nga data: 30/10/2020 deri me 13/11/2020. Adresa e zyrës Rr "UÇK" Nr. 7, 50000 -Gjakovë - Kosovë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, ndërsa aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen .

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se “Dibra Med” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 810802034 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Dibra Med”, D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. Unik Identifikues: 810802034, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Dibra Med” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. Unik Identifikues: 810802034, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU

Nr. 612480
Prishtinë, 14/04/2014

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 2.4, 4.1 dhe 12.6 të Ligjit për Arsimin e Lartë, nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, Udhëzimit administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës (nr. 08/2010), kërkesës së znj. Arlinda Gashi të datës 03.10.2013, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr:

VENDIM

1. Znj. Arlinda Gashi i njihet grada "Inženjerka Šumarstva", 180 ECTS, studime tre vjeçare, e fituar në "Sveučilište u Zagrebu".
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar nga ana juaj, Këshilli Shtetëror për Njohje vendosi që të njihet grada e fituar në "Sveučilište u Zagrebu" në Kroaci, ashtu si është e precizuar në dokumentin e lëshuar nga ky institucion: "Inzhinier e shkallës së parë të pylltarisë". Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga kandidata dhe nga informacionet e marra nga institucionet përkatëse nga vendi ku janë kryer studimet, Këshilli Shtetëror për Njohje arsyeton se programi i studimeve është tre vjeçar dhe ka 180 ECTS, prandaj vendosi si në dispozitiv të vendimit.


Këshilla Juridike: Pala e pa kënaqur me vendimin ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankesa në MASHT në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Palës,
2. Komisionit,
3. Qendrës NARIC,
4. Arkivit në MASHT,

Bekim Samadaxha
[Signature]
Kryetar i Këshillit Kombëtar për Njohje


Xhavit Dakaj
[Signature]
Sekretar i përgjithshëm


 **Gjej PUNË**

• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Noc Doqaj shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U. "Selman Riza" ne Gjakovë. nga kl. I - VIII.
- ▶ Anton Doqaj shpall te pa vlefshme dëftesën e plot te Sh.F.M.U. "Selman Riza" ne Gjakovë nga kl. I - VIII.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- ▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.
- ▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

Në bazë të dispozitave të nenit 21, neni 25 paragrafi 25.2 pika h) të Ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht neni 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), Komisioni i Auditimit i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Çabrati" Sh.A, në Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **20.10.2020**, mori vendim që të shpall:

KONKURS

Pozita: Auditor i Brendshëm.
I përgjigjet: Komisionit të Auditimit.
Vendi: Gjakovë.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;
- Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transaksionet e NP, komfor objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;
- Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;
- Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;
- Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;
- Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;
- Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekt deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;
- Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlidhura me to;
- Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga Komisioni i Auditimit;

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përmbushë të gjitha kushtet e pavarësisht ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;
- Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëmitë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/apo Financave dhe Kontabilitetit;
- Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm nga institucionet e licencuara në vend ose jashtë tij;

Njohurit dhe shkathtësitë profesionale

- Njohuritë e qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;
- Njohuri e Ligjeve, Rregulloreve dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;
- Shkathtësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;
- Shkathtësi kompjuterikë në programet kompjuterike, Micr. Word, Excel dhe Acces;
- Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën për Auditor të Brendshëm,
- Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,
- Letër Motivimin,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: Për pozitën: Auditor i Brendshëm i KRM "Çabrati" Sh.A. Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Komisioni i Auditimit e mban të drejtën e formimit të listës së ngushtë me aplikantët.

Konkursi është i hapur nga data **30 tetor 2020 - 30 nëntor 2020, ora 16:00.**



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

U skladu sa odredbama člana 21., člana 25. stav 25.2 tačka h) Zakona br. 03 / L-087 o preduzećima u javnom vlasništvu („Službeni list Republike Kosovo”, br. 31/15. Jun 2008), odnosno član 13 Zakona br. 04 / L-111 o izmeni i dopuni zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima (Službeni list Republike Kosovo "br. 13/30. Maj 2012. godine), Komisija za reviziju Regionalne kompanije za otpad, Cabrati "AD, u Đakovici, na sastanku održanom: **20.10.2020**, odlučio je da objavi:

KONKURS

Pozicija: Unutrašnji revizor.
Odgovara: Komisiji za Reviziju.
Mesto: akovica.

Zadaci i Odgovornosti.

- Rukovođenje, upravljanje i unutrašnju organizaciju Kancelarije za reviziju;
- Sastavljanje revizorskih postupaka, odnosno plana interne revizije za sve transakcije PJ, u skladu sa ciljevima unutrašnje kontrole, politikama i procedurama JP, na osnovu važećeg zakona;
- Revizija investicionih i finansijskih planova PJ, godišnjeg poslovnog plana i godišnjeg budeta;
- Revizija godišnjeg bilansa stanja i bilansa uspeha, kao i finansijskih izveštaja propisanih zakonom;
- Objektivna procena i efikasna upotreba resursa PJ, kao i davanje adekvatnih preporuka Odboru za reviziju;
- Verifikacija adekvatnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i postupaka koji imaju za cilj da garantuju sprovođenje od strane PJ svih zakona primenljivih na Kosovo tokom vršenja njegove delatnosti i da pruže Komisiji za Reviziju sve primedbe ili sugestije koji se smatraju neophodnim;
- Redovna verifikacija adekvatnosti i pravilnog funkcionisanja sistema i procedura kojima je cilj osigurati da se knjige i dokumentacija JP, uključujući finansijsku dokumentaciju, vode u skladu sa računovodstvenim standardima i Zakonom i da projekti izveštaji finansijski godišnji koji se redovno pripremaju;
- Analiza poslovnih sistema i procesa i srodnih kontrola;
- Redovno izveštavanje od strane Komisije za reviziju i ispunjavanje bilo kojih drugih dužnosti koje mu dodeli odbor za reviziju;

Plata: U skladu sa politikom nadoknade koju je odobrio Odbor direktora,

Potrebnii uslovi i kvalifikacije:

Komisija za reviziju želi da se osigura da su svi potencijalni kandidati osobe priznatog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove prema članu 17.1 Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima dopunjen i dopunjen Zakonom br. 04 / L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima, a takođe i svaki kandidat mora da ispuni sve uslove nezavisnosti predviđene članom 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima dopunjen i dopunjen Zakonom br. 04 / L-111 o izmenama i dopunama zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima. Pored ovih opštih uslova, kandidati moraju ispunjavati i sledeće posebne uslove:

- Da ima univerzitetsku diplomu iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija, računovodstva ili drugih oblasti studija relevantnih za sektor koji treba revidirati;
- Najmanje tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u oblastima interne revizije, unutrašnje kontrole i / ili finansija i računovodstva;
- Da je certificiran kao interni revizor kod licenciranih institucija u zemlji ili inostranstvu;

Stručna znanja i veštine

- Poznavanje savremenih pristupa planiranju i kontroli;
- Poznavanje važećih zakona, propisa i administrativnih uputstava;
- Komunikacione veštine, planiranje rada i liderske sposobnosti revizorskih aktivnosti;
- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i formulisanje preporuka i profesionalni saveti;
- Organizacione veštine praćenja primene preporuka kako bi se one blagovremeno primenile;
- Računarske veštine u softveru, Micr. Vord, Ekcel i Acces;
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Kandidat mora dostaviti sledeće dokaze:

- Aplikaciju,
- CV,
- Dokaz o obrazovanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Sertifikat internog revizora,
- Reference, kao i druge profesionalne potvrde,
- Motivaciono pismo,
- Potvrda da nije pod istragom (ne starija od 3 meseca),
- Kopija ličnog dokumenta,

Kompletni dokumenti se dostavljaju Sekretarijatu Kompanije u zatvorenoj koverti sa napomenom: Za radno mesto: Interni revizor RKO "Çabrat" AD. Formalna evaluacija kandidata i intervjui obaviće se u optimalno vreme nakon isteka roka za prijavu. Komisija za reviziju zadržava pravo da formira uži spisak kandidata.

Konkurs je otvoren od **30. oktobra 2020. do 30. novembra 2020. u 16:00.**



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakova

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nën 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, u. d. Kryeshefi Ekzekutiv me datë 29.10.2020 vendosi që me datë 30.10.2020 të shpallë:

Konkurs publik

Për këto pozita

I. 1 /një/ **ARKËTAR/E** kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Kushtet:

Të posedojë nivelin e edukimit Bachelor - drejtimi ekonomik, të ketë më së paku 3 (tre) vite përvojë të punës relevante, të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës, preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku, të mos jetë i dënuar apo nën hetime .

Kushtet e veçanta:

Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Varësisht nga performanca e tij do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Referenca e përvojës 3 (tre) vite në punët relevante, të posedoj patentë shoferin me "B" kategori së paku, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurron , Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më e re se gjatë muaj) dhe Letër Njoftimi.

II. 1 /një/ **SHOFER me "C" Kategori me** kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare, me mundësi vazhdimi.

Kushtet:

Të posedojnë më së paku shkollim fillor, të posedoj patentë shoferin me "C" kategori, të ketë më së paku 1 (një) vit përvojë të punës për pozitë relevante, të ketë aftësi të mira fizike për punë me ngarkesa, të mos jetë i dënuar apo nën hetime, dhe Letër Njoftimin .

Kushtet e veçanta:

Të ketë aftësi të mira psikofizike të punës, puna kryhet me ngarkesa shtesë të detyrave të punës dhe në vende të ndryshme varësisht nga nevoja e punëdhënësit dhe mundësi të ndërrimit të vendit të punës për pozitë ekuivalente. Punëtori 6 / gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij/saj do t'i vazhdohet apo do t'i ndërpritet kontrata e punës.

Dokumentet e kërkuara:

Kërkesa, CV-ja, Diploma , Patent Shoferi me "C" kategori, Referenca e përvojës 1 (një) vjeçare në punët relevante, të posedoj raport mjekësor se ka aftësi të mira për punë për pozitën që konkurron, Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i dënuar (më e re se gjatë muaj) dhe Letër Njoftimi.

Detyrat e punës: Për të dy pozitat ato mund t'i gjeni në veb faqen e kompanisë www.cabrati.com

Afati i paraqitjes së kërkesave për të dy pozitat është 15 ditë nga dita e publikimit, (nga data 30.10.2020 deri me datë 19.11.2020, ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek sekretaria- Udh. Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit dhe intervistës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGJIU
Nr. 6124/20

Prishtinë, 14/04/2014

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 2.4, 4.1 dhe 12.6 të Ligjit për Arsimin e Lartë, nenin 17 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, Udhëzimit administrativ për parimet dhe procedurat e njohjes së gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës (nr. 08/ 2010), kërkesës së znj. Arlinda Gashi të datës 03.10.2013, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr:

VENDIM

1. Znj. Arlinda Gashi i njihet grada "Inženjerka Šumarstva", 180 ECTS, studime tre vjeçare, e fituar në "Sveučilište u Zagrebu".

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të parashtruar nga ana juaj, Këshilli Shtetëror për Njohje vendosi që të njihet grada e fituar në "Sveučilište u Zagrebu" në Kroaci, ashtu si është e precizuar në dokumentin e lëshuar nga ky institucion: "Inžiniere e shkallës së parë të pylltarisë". Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga kandidatja dhe nga informacionet e marra nga institucionet përkatëse nga vendi ku janë kryer studimet, Këshilli Shtetëror për Njohje arsyeton se programi i studimeve është tre vjeçar dhe ka 180 ECTS, prandaj vendosi si në dispozitiv të vendimit.

Këshilla Juridike: Pala e pa kënaqur me vendimin ka të drejtë ankese në Komisionin për Ankese në MASHT në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së Vendimit.

Vendimi i dërgohet:

1. Palës,
2. Komisionit,
3. Qendrës NARIC,
4. Arkivit në MASHT,

Bekim Samadrxha

Kryetar i Këshillit Kombëtar për Njohje

Khavit Dakaj

Sekretar i përgjithshëm

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

Një muaj pa me të dashurin tonë



BASHKIM (Haxhi) BRAHAJ

(Profesor - Veteran i luftës)

Askush nuk është i përjetshëm, të përjetshme janë veprat dhe kujtimet që mbetin nga e kaluara.

Sot u bë një muaj që kur ti u shkëpute nga ne, për të ikur atje largë, atje ku më s'takohemi.

Të deshëm aq shumë, prandaj e kemi të vështirë të mësohemi pa një shtyllë të fuqishme të familjes sic ishe ti.

Shkolla nuk e ka më kuptimin e njejtë, nxënësit nuk e kanë më pranë tyre një figurë si ti.

Atdhedashuria jote ishte piedestale. Kontributi yt ishte i

jashtëzakonshëm nëpër periudha të errëta të vendit. Ti ndricove gjithmonë në rrugët që more.

Prandaj, vendi yt është tek të vlersëuarit, tek ata që nuk harrohen.

Të shohësh vendin tënd bosh është e dhimbshme, të shohësh që cdo mëngjes e cdo mbrëmje nuk dëgjohet më zëri yt është e dhimbshme. Por, jeta është kjo dhe ne duhet t'pajtohemi me ikjen tënde.

Do të kujtojmë përherë, me shumë dashuri.

Të pikëlluar:

Nëna: Halimja

Gruaja: Hadija

Djali: Vllaznimi

Vajzat: Mirlinda, Nora, Anza,

Donika, Valmirja, Xhemilja

Vëllezërit: Bajrami dhe Iliri

Motrat, nipat, mbesat dhe tërë farefisi Brahaj.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales






Bujar Salihu (1972) është nga Pogradja e Gjilanit. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Në vitin 1990 filloi studimet në Fakultetin Elektroteknik të Universitetit të Prishtinës por, për shkak të rrethanave politike, u detyrua t'i braktisë ato dhe Kosovën. Që nga viti 1992 jeton në Zvicër. Ka botuar përmbledhjet poetike: *Në xipat e vetmisë* (1994), *Më pak se jetë* (1997), *Skeleti i dallëndyshes* (2002). Poezitë e tij janë përfshirë në disa antologji dhe janë përkthyer në disa gjuhë. Është fitues i disa çmimeve letrare. *Linga e heshtjes* është libri i tij i katërt.

26 vjet më parë, në moshën 22 vjeçe, një libër me poezi e botoi në dy gjuhë, në shqip dhe në frëngjisht. Pas botimit të librit të parë më 1994, i botoi edhe dy të tjerë dhe, me disa autorë shqiptarë, foli në disa gjuhë pasi disa përgatitës hartuan antologji me poezi shqipe. Veçantitë e tij letrare i kemi vënë re qëmoti, por edhe i kanë zënë ngoje Ali Podrimja, Shaip Beqiri, Mustafë Xhemaili, Arif Molliqi, Faik Shkodra, Xhemail Ahmeti, Nexhat Rexha e ndonjë tjetër që tash s'po na kujtohet. Prandaj, duke pasur veçanti më tepër se disa poetë të tjerë e duke qenë poezia e tij objekt krahasimi me atë të A. Tufës, L. Leshanakut, A. Balës, B. Cufajt, V. Berishës, R. Zekthit, I. Belliut, D. Gashit, M. Mavrajt, Xh. Beqirit, L. Arapit, Rr. Paçarizit, E. Hatibit etj., disa poezi të Bujar Salihut i kemi botuar në revistën *Akademia*. Me kalimin e viteve, ai duke shtuar veçantitë gjuhësore dhe tematike në poezi e ne duke veneruar krijimet e tij, këtë herë i botojmë këtë libër, i cili një shok tjetër e ka të rrallë. Lexojini të gjitha poezitë e këtij libri, por mos harroni t'i lexoni dy herë poezitë *Dita jote e fundit*, *Buka*, *Eja të pajtohemi*, *Veshkat e vyshkura*, *Hija e qershisë*, *S'e mbajte premtimin*, *E përvojshme*, *Puthje*, *Mbrëmë*, *Në vend të pasthënies* dhe t'i mësoni përmendësh sepse fjalët, fjalitë, figurat, temat dhe motivet e tyre ju duhen shumë në jetën e përditshme.

Bujar Salihu



LINGA E HESHTJES

(poezi)

Linga e heshtjes

Bujar Salihu

4⁹⁹ €



Sh. B. Armagedoni



Arben Veselaj është gazetar dhe autor i disa librave letrarë. Ka mbaruar studimet themelore dhe ato postdiplomike për letërsi në Universitetin e Prishtinës. Punon redaktor për kulturë në Radiotelevizionin e Kosovës. Në periodikët letrarë dhe shkencorë shqiptarë ka publikuar kryesisht kritikë dhe studime letrare. Disa nga tregimet dhe esetë e tij janë përfshirë në antologji të ndryshme. Në vitin 2001 botoi librin me poezi *Shpërrallosje*, kurse në vitin 2017 studimin *Tema*

kadareane. Më 2017, për zhanrin e kritikës dhe të eseistikës, u laureua nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës me Çmimin Vjetor për Letërsi.

Kur e kam lexuar dorëshkrimin *Triptikon arbëresh* të autorit Arben Veselaj më kanë ndodhur tri fenomene: 1. Disa herë më është dashur t'u kthehem disa faqeve përsëdyt, pasi më rrëmbente rrëfimi dhe shpesh nuk arrija të parashikoja asgjë - parashikimet më dilnin huq; 2. Jam kthyer në kohë dhe kam bashkëjetuar, para së gjithash, me De Radën e me Skiroin, pikërisht në sheshin e Shën Mitrit e të fshatrave të tjera arbëreshe të Kalabrisë e të Sicilisë; dhe 3. E kam lakmuar Arbenin që ka shkruar diçka që kam planifikuar së paku një tri vjet. Një krijim që arrin me i shkakti këto kokëçarje e kënaqësi, unë e përjetoj si kryevepër. E, ky libër ka histori, letërsi, politikë, peizazh... kulmi është shlyerja e kufijve zhanrorë që Arben Veselaj arrin ta bëjë.

Dr. Rrahman Paçarizi

Qasja askematike dhe johistoriciste mbi gjenezën e letërsisë shqipe dhe qytetërimin modern shqiptar, e bën këtë vepër unike dhe me rëndësi në studimet e albanologjisë. Libri *Triptikon arbëresh* i gazetarit dhe studiuesit Arben Veselaj është një adresë e re me vlerë të veçantë për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj, mbi shumë të panjohura që qëndrojnë të stivuar e të pluhurosura faqeve të historisë së qytetërimit shqiptar. Rrëfyer nga sfondi i një ekspedite personale prej një gazetari e studiuesi të letërsisë, ky libër përbën sintezën e historisë letrare, politike dhe fetare të botës arbëreshe. Thellësia studimore, kombinuar me artin e të rrëfyerit, herë si shtjellim letrar e herë si reportazh, e bën atë shumë të dobishëm edhe për studentët e gazetarisë. Një apoteozë e madhështisë arbëreshe që na mban frymën gjatë të lexuarit.


Dr. Arben Fetosbi

4⁹⁹ €



Triptikon arbëresh

Arben Veselaj



ARBEN VESELAJ

TRIPTIKON ARBËRESH

(historikja, estetikja, ikonikja)

-  **S. GIORGIO ALB.**
Mbuzati
-  **VACCARIZZO ALB.**
Vakarici
-  **S. COSMO ALB.**
Strighari
-  **MACCHIA ALB.**
Maqi